



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

Dokument parlamentar

PROCESVERBAL

Datë 08.07.2015, ora 10:00

Drejton mbledhjen:

Fatmir Xhafaj – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

1. Projektligji “Për shërbimet dhe produktet biocide në shëndetin publik”.
2. Votimi në tërësi i projektligjit “Për turizmin”.
3. Projektligji “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 125/2013 “Për koncesionet dhe partneritetin publik dhe privat” të ndryshuar”.
4. Projektligji “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”.

Marrin pjesë:

Fatmir Xhafaj, Oerd Bylykbashi, Bashkim Fino, Dashamir Peza, Pandeli Majko, Ulsi Manja, Vasilika Hysi, Vexhi Muçmataj, Anila Agalliu, Petrit Vasili, Silva Caka, Eduard Halimi, Arben Ristani, Gent Strazimiri, Tahir Muhedini, Nard Ndoka, Pirro Lutaj.

Mungojnë:

Fatmir Mediu, Mhill Fufi, Tom Doshi.

Të ftuar:

Klodian Rjepaj – zëvendësministër i Shëndetësisë.

Andoneta Njehrrëna – shefe e Sektorit Juridik në Ministrinë e Shëndetësisë.

Ervin Mete – zëvendësministër i Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë, dhe Sipërmarrjes.

Ardit Çollaku – këshilltar i ministrit të Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes.

Rovena Beqiraj – kryetare e Agjencisë së Trajtimit të Koncesioneve “ATRAKO”.

Gazmend Vehbi – specialist pranë Agjencisë “ATRAKO”.

Plarent Ndreca – sekretar i Përgjithshëm i Ministrisë së Arsimit dhe Sporteve.

Aleksandër Xhuvani – anëtar i Komisionit të Arsimit të Lartë.

Erzen Tola – drejtor i Drejtorisë Juridike në Ministrinë e Arsimit dhe Sporteve.

Erjon Muharremaj – këshilltar juridik i Komisionit të Arsimit të Lartë.

HAPET MBLEDHJA

Fatmir Xhafaj – Fillojmë mbledhjen e komisionit!

Sot rendi i ditës është pak i ngarkuar, por besoj që do t'ia dalim me sukses që t'i përfundojmë ato që kemi programuar.

Si pikë të parë të rendit të ditës kemi shqyrtimin e projektligjit “Për shërbimet dhe produktet biocide në shëndetin publik”, projekt i sjellë nga qeveria dhe i iniciuar nga Ministria e Shëndetësisë, me sa kuptoj, ndaj i pranishëm për të mbrojtur këtë projektligj është zëvendësministri i Shëndetësisë, zoti Klodian Rjepaj.

Mirë se keni ardhur, zoti Zëvendësministër!

Ne nuk jemi komision përgjegjës. Fillimisht do të donim të dëgjonim një paraqitje të përmbledhur të projektit, nëse ka diçka që ka interes për komisionin tonë, dhe pastaj eventualisht do të vijojmë me pyetje nga kolegët dhe përgjigjet tuaja.

Fjala për ju.

Klodian Rjepaj – Faleminderit, zoti kryetar!

Sot kemi sjellë para jush projektligjin “Për shërbimet dhe produktet biocide në shëndetin publik”. Në fakt, është një nevojë e bazuar edhe në eksperiencat e deritanishme për hartimin e këtij projektligji, për shkak se deri sot produktet biocide të konsideruara si lëndë dezinfektuese, dezinfektuese dhe deratizuese, pra ato që janë 3D, kanë pasur zhvillime edhe në nivel kombëtar, pra të brendshme, që para vitit 1993 dhe pas këtij viti, por edhe zhvillime në dy vjetët e fundit, të cilat na kanë detyruar që ta ndërtojmë si projektligj për ta sjellë për miratim, në radhë të parë, për të rregulluar edhe problematikën që kanë pasur të bëjnë deri sot me rregullimin e tyre, pasi nuk është i plotë për këto produkte, të cilat mund të sjellin edhe dëme në organizmin e njeriut apo të gjallesave të vertebrave.

Mund t'ju them që rregullimi i tyre i vetëm është në ligjin “Për shëndetin publik”, të miratuar disa vjet më parë, por aty nuk përcaktohen specifikisht çështjet e mbrojtjes së shëndetit apo të ndalimit të atyre që janë vektorë të transmetimit të sëmundjeve.

Produktet biocide përdoren për kontrollin e vektorëve që transmetojnë sëmundje, pra nga insektet, rriqrat apo rodentët tek organizimi i njeriut.

Kontrolli i vektorëve është një masë thelbësore për parandalimin dhe luftimin e sëmundjeve infektive. Kështu që vektorët me ndikim në shëndetin publik përfshijnë mushkonjat, flebotomet, mizat, rriqrat, furrtalet, morrat, tartabiqet, pleshtat, akarienët, si dhe brejtësit. Prandaj kemi ndërmarrë këtë iniciativë për ta sjellë ligjin në parametra, të cilët ndihmojnë ose parandalojnë përhapjen e këtyre sëmundjeve, por edhe që rregullojnë prodhimin, shpërndarjen dhe përdorimin e këtyre produkteve duke përcaktuar rolet dhe përgjegjësitë sipas institucioneve, duke u nisur që nga pushteti lokal tek trupat e reja inspektuese që janë krijuar, pra Inspektorati Shtetëror Shëndetësor apo edhe te roli i Institutit të Shëndetit Publik, si dhe aktorët e tjerë të cilët janë pjesë e parandalimit të përhapjes së sëmundjeve infektive.

Në të njëjtën kohë, mund t'ju them që Ministria e Shëndetësisë po punon edhe për hartimin e një ligji të ri për sëmundjet infektive. Ai ligj do të jetë më i plotë në lidhje me sëmundjet infektive, por ky projektligj shihet edhe si pjesë e panoramës së madhe për parandalimin dhe luftimin e sëmundjeve infektive në Shqipëri.

Para vitit 1993 procesi i dezinfektimit, dezinfektimit dhe deratizimit është kryer nga Ministria e Shëndetësisë dhe institucionet e saj të varësisë. Pas vitit 1993, me vendim të Këshillit të Ministrave, ky proces iu la pushtetit lokal, por mund t'ju them që pushtetit lokal, megjithëse në vitin 1993 nga Ministria e Financave iu lanë edhe asetet, edhe burimet njerëzore, edhe burimet financiare, deri sot ose, më saktë, deri para dy vjetësh, për shkaqe të ndryshme e të shumta, proceset e dezinfektimit, të dezinfektimit dhe të deratizimit nuk janë kryer në Republikën e Shqipërisë deri kur para dy vjetësh Ministria e Shëndetësisë ndërmori një hap pikërisht duke parë që kishim shtim të atyre që potencialisht mund të ishin vektorë të transmetimit të sëmundjeve, kryesisht edhe mushkonjat anafele.

Me rishfaqjen e saj në ligatinat apo në zonat bregdetare të Shqipërisë, duke parë edhe rrezikun e rishfaqjes së malaries u ndërmor një hap i rëndësishëm për të filluar dezinfektimin, por besojmë që një zhvillim i rëndësishëm, siç është reforma administrativo-territoriale, do t'i japë dhe duhet t'i japë më shumë rol pushtetit lokal, i cili ka një rol të rëndësishëm në ofrimin e shërbimeve për parandalimin e sëmundjeve infektive, pra për kryerjen e dezinfektimit, të dezinfektimit dhe të deratizimit.

Natyrisht, një bazë e rëndësishme është që në Shqipëri ka ende shumë faktorë favorizues për përhapjen e sëmundjeve infektive dhe zhvillimin e vektorëve, pra ekzistenca e ligatinave të shumta përgjatë zonës bregdetare Shkodër-Sarandë, përgjatë bregdeteve Adriatik dhe Jon, si një habitat i përshtatshëm për zhvillimin dhe shumimin e mushkonjave, niveli jo i duhur i higjienizimit në zonat rurale dhe urbane, bllokimi i kanaleve të bonifikimit, mbushja e tyre me vegjetacion dhe rrjedhja ngadalë e ujit bëjnë të mundur që edhe larvat e mushkonjave të zhvillohen.

Ekzistenca e zonave, sidomos në qendrat urbane, të cilat mbajnë ujë dhe nuk pastrohen apo që nuk dezinfektohen, si hendeqe, kanale, bodrume, strehime, bunkerë, rezervuarët e ujërave të zeza, fuçitë me ujë apo depozitat, apo edhe përhapja dhe ekzistenca në territor e gomave të përdorura janë një sërë elementesh që ndikojnë në këtë drejtim.

Gjithashtu, nga pikëpamja e faktorëve të jashtëm, do të thosha, edhe për arsye të përjasjes me rregulloren nr. 528/2012 të Parlamentit Europian “Për vendosjen në treg dhe përdorimin e produkteve biocide” kemi bërë edhe një përafrim të pjesshëm, për shkak se rregullimi aktual i tregtimit dhe i aplikimit të produkteve biocide nuk është harmonizuar me procedurat e regjistrimit dhe vendosjes në treg të produkteve për mbrojtjen e bimëve, rregulluar me ligjin nr.9362, datë 24.03.2005.

Disa risi të këtij projektligji janë: në këtë projektligj përcaktohet kuadri rregullator i klasifikimit, i regjistrimit, i prodhimit, i hedhjes në treg, i ruajtjes dhe i transportit të produkteve biocide, pra është kapur një gamë e gjerë, por, nga ana tjetër, siç e thashë më parë, janë përcaktuar edhe rolet e disa institucioneve, ku besoj unë që rol parësor merr pushteti lokal, i cili do të ofrojë tashmë këtë shërbim, ku fuqimisht besoj se ndoshta Ministria e Shëndetësisë, siç e thashë më parë, për shkak edhe të situatës në shëndetin publik, dy vjet më parë mori iniciativën për të filluar procesin e dezinfektimit, por nuk është dhe nuk mund të jetë rol vetëm i Ministrisë së Shëndetësisë në të gjithë territorin.

Besoj që njësitë e reja administrative do të kenë një rol më të madh duke e ofruar këtë shërbim, duke e njohur më mirë zonën. Nga ana tjetër, ky ligj i shërben edhe mbrojtjes së faunës për shkak se një pjesë e këtyre produkteve biocide, të cilat ndahen edhe në risk të lartë, edhe në risk të ulët, pra ka mekanizma të fortë kontrolli, nëpërmjet

edhe trupave të reja inspektuese, siç thashë më parë, të Inspektoratit Shtetëror të Shëndetit.

Në këtë projektligj përcaktohen edhe masat administrative dhe roli i Inspektoratit në zbatimin e këtij ligji.

Natyrisht, roli i Ministrisë së Shëndetësisë mbetet supervizues në nivel kombëtar, por ka një rol edhe Instituti i Shëndetit Publik, i cili është institucion kërkimor-shkencor në aspektin shkencor dhe në monitorimin e këtij ligji.

Faleminderit!

Fatmir Xhafaj – Faleminderit, zoti Zëvendësministër!

Fjalën e ka relatori.

Vexhi Muçmataj – Faleminderit, zoti kryetar!

Projektligji “Për shërbimet dhe produktet biocide në shëndetin publik” vjen si nismë e Këshillit të Ministrave. Komisioni i Ligjeve e shqyrton këtë projektligj bazuar në nenet 32 dhe 38 të Rregullores së Kuvendit.

Ky projektligj ka për qëllim të mbrojë shëndetin e njerëzve dhe të kafshëve, si dhe mjedisin nga organizmat e dëmshme nëpërmjet përdorimit të sigurt të produkteve biocide, duke synuar të rregullojë mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të kontrollit të organizmave të dëmshme për shëndetin publik në mjediset publike dhe private nëpërmjet përdorimit të produkteve biocide, vendosjen në treg të lëndëve biocide, vendosjen në treg të lëndëve biocide, produkteve biocide dhe produkteve të trajtuara, prodhimin, importin dhe eksportin e lëndëve biocide, produkteve biocide dhe produkteve të trajtuara.

Ky projektligj vjen natyrisht si nevojë e rregullimit ligjor të kësaj fushe, pasi aktualisht kushtet dhe procedurat për regjistrimin, prodhimin, paketimin, transportimin, ruajtjen, hedhjen në treg dhe përdorimin e produkteve biocide për kontrollin e organizmave të dëmshme për shëndetin publik në territorin e Republikës së Shqipërisë rregullohen me akte nënligjore në zbatim të nenit 33 të ligjit nr.10938, datë 11.05.2009 “Për shëndetin publik”.

Projektligji rregullon jo vetëm kushtet e vendosjes në treg të produkteve biocide, si ato të prodhuara në vend, ashtu edhe ato të importuara, por përcakton edhe rolin dhe përgjegjësinë e aktorëve të ndryshëm për ofrimin e sigurt të shërbimeve biocide.

Duke e parë në tërësi projektligjin, u propozoj kolegëve që ta miratojmë në parim, duke rezervuar të drejtën që gjatë shqyrtimit nën për nën të bëj disa propozime konkrete për disa ndryshime.

Fatmir Xhafaj – Faleminderit, zoti Muçmataj!

Ka pyetje?

Po, zoti Fino.

Bashkim Fino – Faleminderit, zoti kryetar!

Më duket një projektligj interesant, por dua të di nga zoti zëvendësministër: si do të realizohet në terren bashkëpunimi me organet e pushtetit vendor tani me ndarjen e re territoriale që produktet biocide të jenë produkte që do t'i përdorin ata në çdo kohë dhe në çdo moment, siç e thatë edhe ju vetë në komentin tuaj, se nga viti 1993 e këtej, pushteti vendor nuk ka pasur dot mundësi dhe aftësitë për ta bërë një gjë të tillë?

Pyetja e dytë që kam, të paktën ne po e bëjmë një ligj dhe nuk jemi keq për të bërë ligje, por jemi në një sezon turistik në këto momente. A janë marrë masat nga Ministria e Shëndetësisë, të paktën para se të miratohet ligji që do t'i japë drejtimin e duhur pastaj se kush do të ketë kompetencë që të bëhet të paktën dezinfektimi i zonës kryesore nga Shkodra deri në Sarandë të plazheve, ku insektet e gjëra të ndryshme janë shumë të dëmshme edhe për pushuesit? Këto janë dy gjëra të cilat mua më shqetësojnë, por pyetja e parë më shqetëson më shumë, pra mirë në këtë ligj, por a do të jenë komplementarë edhe me ligjin e decentralizimit të pushtetit vendor që do të kenë kompetencë me fonde, me njerëz, me zyra të merret konkretisht me këtë punë, jo vetëm për pjesën e plazhit, se ka edhe shumë insekte të tjera, siç e përdorët ju nga pikëpamja profesionale, në zonat malore mund të jenë edhe më të dëmshme, në bagëtitë apo në të gjitha gjërat? Kjo më shqetëson më shumë.

Faleminderit!

Fatmir Xhafaj – Faleminderit, zoti Fino!

Po, zoti Zëvendësministër.

Klodian Rjepaj – Faleminderit!

Në lidhje me pyetjen e parë, besoj unë që është goxha komplekse dhe, siç edhe ju, edhe gjatë punës që po bëhet në Ministrinë e Shëndetësisë, të cilën ministri ma ka ngarkuar mua, të merrem me sesi do të reformohet edhe shërbimi shëndetësor, pra

mbrojtja e shëndetit të popullatës në funksion të reformës së re administrativo-territoriale. Besoj që një nga elementet kyç në ofrimin e shërbimeve, sidomos ato të cilat janë shërbime për mbrojtjen e shëndetit publik, shërbime me bazë komunitare dhe shërbime të cilat kanë nevojë për njohjen specifike dhe njohjen e detajuar të situatës në terren, roli i pushtetit vendor do të jetë shumë i madh. Pra, nuk do të jetë vetëm çështja e dezinfektimit, dezinfektimit dhe deratizimit, por Ministria e Shëndetësisë po mendon që të jetë një paketë e ofrimit të shërbimit shëndetësor edhe në nivelin parësor. Pra, pushteti vendor do të ketë rol më të madh në ofrimin e shërbimit parësor dhe në mbrojtjen e shëndetit publik, dhe besojmë se do të jetë pjesë e një pakete më të madhe se vetëm ofrimi i këtyre tre shërbimeve që kanë të bëjnë me dezinfektimin, dezinfektimin dhe deratizimin.

Me të drejtë ju thatë që nga viti 1993 deri në vitin 2013 pushteti vendor ka pasur të drejtën për ta ofruar këtë shërbim, por nuk e ka ofruar, unë besoj që pikërisht edhe fryma e vetë reformës administrative ka qenë që “me më pak njësi administrative, të kemi më shumë mundësi për të ofruar shërbime”.

Ministria e Shëndetësisë dhe Instituti i Shëndetit Publik kanë bërë një punë mjaft të mirë paraprake, sepse në periudhën 2013-2014, pra një vit ne punuam për të hartuar një strategji të qartë dhe tashmë ajo është edhe me elementet e duhura të teknologjisë për të pasur edhe hartat dixhitale të të gjitha lagunave, ligatinave, të të gjithë bregdetit ku potencialisht mund të ketë rritje të insekteve apo të vektorëve të transmetimit të sëmundjeve infektive.

Unë besoj se ky *know-how* do t'i transferohet pushtetit lokal së bashku, ndoshta, se ende nuk jemi të qartë, ne po mendojmë që nga Ministria e Shëndetësisë të ketë mundësi grantesh për pushtetin lokal, të cilat të jenë të kushtëzuara, pra grante të cilat do t'i japin pushtetit lokal mundësinë për të ofruar shërbimin parësor dhe të shëndetit publik.

Nga ana tjetër, në lidhje me pyetjen e dytë që ju bëtë kryesisht me bregdetin për sezonin turistik, procesi i dezinfektimit ka filluar që prej një muaji. Është viti i dytë që aplikohet. Ne shpresojmë shumë që nga viti i parë në vitin e dytë të ketë edhe një reduktim të mëtejshëm kryesisht të mushkonjave, të disa llojeve (mushkonjës tigrë, anafele e të tjera). Në vijimësi do të shkojmë drejt një përqindjeje të pranueshme të pranisë së këtyre insekteve në territorin e Republikës së Shqipërisë, por, siç e theksova

edhe më parë, nuk është vetëm dezinfektimi, por ka nevoja të mëdha, prandaj duhet që pushteti lokal të angazhohet, në lidhje me dezinfektimin dhe me deratizimin. Të tria këto janë procese shumë të rëndësishme të cilat duhet të kryhen.

Natyrisht, ky projektligj ndërhyt edhe në atë që quhet mbrojtje e mjedisit, për shkak se, siç e dini, dezinfektimin po e bëjmë me një produkt biologjik, pra nuk është produkt që dëmton florën dhe faunën. Besoj që edhe në frymën e këtij projektligji, çështja e mbrojtjes së mjedisit është e sigurtuar, pra ruajtja e marrëveshjeve dhe konventave ndërkombëtare në lidhje me mbrojtjen e mjedisit.

Faleminderit!

Fatmir Xhafaj – Faleminderit!

Ka pyetje të tjera? Ka diskutime? Nuk ka.

Kush është dakord në parim? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Faleminderit!

Vazhdojmë nën për nën.

Neni 1. Po, zoti Muçmataj.

Vexhi Muçmataj – Përmbajtja e këtij neni ka nevojë të rishikohet në raport me nenin 1 të direktivës. Për këtë arsye, propozoj të riformulohet si më poshtë: “Ky ligj ka për qëllim të mbrojtë shëndetin e njerëzve, të kafshëve, si dhe mjedisin nga organizmat e dëmshme nëpërmjet përdorimit të sigurt të produkteve biocide”.

Fatmir Xhafaj – Në rregull. Biem dakord?

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Ju lutem, me mikrofon.

Klodian Rjepaj – Shprehemi dakord.

Fatmir Xhafaj – Në rregull.

Dakord.

Neni 2. Dakord?

Miratohet.

Neni 3.

Vexhi Muçmataj – Pika 3 e këtij neni nuk ka karakter normativ, por përmban elemente shpjeguese. Për këtë arsye, propozoj të hiqet.

Fatmir Xhafaj – Besoj biem dakord.

Vexhi Muçmataj – Dakord.

Fatmir Xhafaj – Neni 4 “Përkufizimet”. Dakord?

Dakord. Faleminderit!

Neni 5 “Kriteret e përgjithshme”.

Vexhi Muçmataj – Në pikën 1 të nenit 5 të projektligjit...

Fatmir Xhafaj – Besoj e keni ndërhyrjen për fjalën këtu “mjaftueshmërisht”?
Nuk ka sens.

Vexhi Muçmataj – Po. Në germën “a” të pikës 1 të këtij neni fjala “mjaftueshmërisht” është e papërcaktuar qartë dhe lë hapësira për interpretime subjektive.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Fatmir Xhafaj – Pse?

Vexhi Muçmataj – Propozoj që kjo fjalë të hiqet.

Fatmir Xhafaj – Në rregull.

Klodian Rjepaj – Në radhë të parë, kjo është përkthyer *mot a mot* siç është në nenin 19 të direktivës. Nga ana tjetër, kjo është një nga pikat dhe nuk është e vetme. Domethënë, vijohet me pika të tjera. Kështu që besoj se plotësohet në nenin 5. Kjo është logjika që kemi ndjekur.

Fatmir Xhafaj – Besoj se kjo është logjika që po thotë: a është i efektshëm apo pak i efektshëm?

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Është pak i efektshëm.

Klodian Rjepaj – Është mjaftueshmërisht.

Fatmir Xhafaj – Çfarë do të thotë “mjaftueshmërisht”? Është i efektshëm.

Klodian Rjepaj – E kemi përkthyer nga direktiva. Këtu thuhet: “*sufficiently*”, domethënë mjaftueshëm.

Fatmir Xhafaj – Dakord.

Edhe relatori do të respektojë direktivën e BE-së, por nuk është argument.
Gjithsesi...

Klodian Rjepaj – Po nuk është i vetëm në ligj, prandaj janë dy argumente.

Fatmir Xhafaj – Neni 6 “Klasifikimi i produkteve biocide”. Dakord?

Vexhi Muçmataj – Dakord.

Fatmir Xhafaj – Neni 7. Dakord?

Vexhi Muçmataj – Dakord.

Fatmir Xhafaj – Neni 8? Dakord.

Neni 9.

Vexhi Muçmataj – Dakord.

Fatmir Xhafaj – Në rregull, dakord.

Neni 10.

Vexhi Muçmataj – Dakord.

Fatmir Xhafaj – Dakord.

Faleminderit!

Neni 11 “Shërbimi i produkteve biocide në shëndetin publik”. Dakord?

Vexhi Muçmataj – Dakord.

Fatmir Xhafaj – Në rregull.

Faleminderit!

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Po, urdhëroni.

Bashkim Fino – Je shumë i mirë.

Në pikën 2, zoti kryetar, thuhet: “Shërbimi i produkteve biocide në shëndetin publik realizohet nëpërmjet strukturës përgjegjëse për shëndetin publik në ministrinë përgjegjëse...”. Pra, do të ketë një sektor apo drejtori në ministrinë tuaj, Instituti i Shëndetit Publik që keni?

Keni dy germa “c-në” dhe “ç-në”, ku thoni: “Strukturat rajonale të shëndetit publik...”, besoj e keni fjalën për prefekturat apo për qarqet, nuk e di, “...dhe organet e pushtetit vendor”. Këto janë detyruese? Çfarë do të thotë kjo? Se ne i bëjmë strukturat në ligj dhe mund të mos të realizohen poshtë në terren, as në qark, as në bashki dhe ligji ngelet i pakompletuar dhe i pazbatueshëm.

Klodian Rjepaj – Janë përmendur të gjithë aktorët përgjegjës për realizimin e shërbimeve. Pushteti vendor e kryen në terren, Instituti i Shëndetit Publik bën trajnimet, monitorimet...

Bashkim Fino – Dakord, dakord, por...

Fatmir Xhafaj – Ideja është konkrete. Këto struktura do të ngrihen, apo janë ekzistuese?

Klodian Rjepaj – Janë ekzistuese.

Fatmir Xhafaj – Më thuaj, për shembull, strukturën rajonale të shëndetit publik.

Klodian Rjepaj – Është Drejtoria Rajonale e Shëndetësisë.

Fatmir Xhafaj – Shënojini me radhë: “Drejtoria..”. Pra, “Organet e pushtetit vendor janë:”.

Këshilli nxjerr akte apo drejtuesit që janë kryetarët e bashkive, pra bashkitë?

(Deputeti Fino ndërhyr pa mikrofon.)

Bashkim Fino – ...mirë rajonalet. Duhet që bashkitë dhe ministria përkatëse të dijnë që, kur bëhet një ligj i ri, duhet të ngrejë një sektor të tillë. Është shumë e rëndësishme në administratën...

Fatmir Xhafaj – Ose një nga zyrat që është atje duhet ta ketë si funksion këtë, se mund të mos ketë sektor të posaçëm.

(Deputeti Fino ndërhyr pa mikrofon.)

Atëherë, të specifikohen këto.

Dakord.

Neni 11? Dakord me vërejtjet e bëra.

Neni 12 “Autoriteti kompetent”. Dakord?

Vexhi Muçmataj – Dakord.

Fatmir Xhafaj – Në rregull. Faleminderit!

Neni 13 “Sekretariati”. Dakord?

Vexhi Muçmataj – Dakord.

Fatmir Xhafaj – Në rregull. Faleminderit!

Neni 14. Dakord?

Vexhi Muçmataj – Dakord.

Fatmir Xhafaj – Nga ndryshon sekretariati nga komisioni?

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Më falni, a mund të ma sqaroni se nga ndryshon sekretariati, se e keni zakon kështu, ngrini struktura, shto miell e shto ujë brenda.

Klodian Rjepaj – Sekretariati ka më tepër funksione administrative, ndërkohë që komisioni është tekniko-shkencor, i cili vlerëson të gjithë gamën e produkteve biocide, si dhe propozon në lidhje me tregtimin ose ndalimin...

Fatmir Xhafaj – Lini një këshillimor. Përcaktojeni “komisioni këshillimor”.

Klodian Rjepaj – Është në pikën e parë.

Fatmir Xhafaj – Shënojeni që në titull, që të mos keqkuptohemi, se ngel struktura pas strukture dhe lekë pas lekësh. Po Instituti i Shëndetit Publik, edhe ai institut me shkencëtarë është? Edhe për biocide duhet të këshillohen disa njerëz. Po ata për çfarë e marrin rrogën?

Klodian Rjepaj – Strukturohet.

Fatmir Xhafaj – Po, por kur ke vetë institutin, pse duhet të të këshillojë një tjetër? Nuk jam dakord. Thua se “është Instituti, por dua edhe një këshill përveç Institutit”. Çfarë funksionesh ka Instituti? Këshilla jep ai.

Klodian Rjepaj – Mund t’ju them që pjesa më e madhe e këtij nga Instituti thjesht është formalizuar në këtë organ këshillimor. Është e drejtë e ministrit për të ngritur edhe komitetet, që ngre zakonisht, si Komiteti i Imunizimit. Është pak a shumë në atë funksion.

Fatmir Xhafaj – Ministri mund ta ngrejë në qoftë se ia lejon Kushtetuta dhe ligji, por të paktën ne me ligj të mos i japim një gjë që nuk bën sens, dhe për mua nuk bën sens. Instituti kryen funksione këshillimore. Sa herë e do ministri, i thotë: “Urdhëro, më duhet ky argument”. Sa herë e do Inspektorati...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Dakord, le t’ia kalojmë komisionit dhe pastaj ta vendosë, por nuk më bën sens: strukturë pas strukture është...

Klodian Rjepaj – Ngaqë është një strukturë...

Fatmir Xhafaj – Ne e kemi mbytur këtë vend me struktura.

E dini, ka qenë një shprehje e famshme dikur, nuk e di sa është tani: “Do që të mos bësh një punë, ngri një grup pune”. Edhe neve tani e kemi bërë: “Do që të mos bësh asnjë punë, përdor disa fjalë dhe thuaj, merr disa modele të huaja, vëri në ligj dhe je në rregull; asnjë punë nuk bëhet.

Klodian Rjepaj – Jo, zoti kryetar, është strukturuar për shkak se lëshon edhe disa akte ky si komision në lidhje me refuzimin e licencave ose me mospranimin. Kështu që..

Fatmir Xhafaj – I ka sekretariati.

Në rregull, ju bini dakord, por mua nuk më bën sens.

Neni 14, për ta riparë.

Neni 15 “Instituti i Shëndetit Publik”, detyrat që ka. Dakord?

Vexhi Muçmataj – Dakord.

Fatmir Xhafaj – Neni 16?

Vexhi Muçmataj – Dakord.

Fatmir Xhafaj – Neni 17?

Vexhi Muçmataj – Dakord.

Fatmir Xhafaj – Faleminderit!

Neni 18?

Vexhi Muçmataj – Dakord.

Fatmir Xhafaj – Neni 19?

Vexhi Muçmataj – Dakord.

Fatmir Xhafaj – Neni 20?

Vexhi Muçmataj – Dakord.

Fatmir Xhafaj – Neni 21?

Vexhi Muçmataj – Në nenin 21 propozojmë që titulli të ndryshohet si më poshtë: “Mbarëvajtjet administrative dhe gjobat”.

Fatmir Xhafaj – Dakord, meqenëse i keni këtu.

Neni 22?

Vexhi Muçmataj – Edhe për nenin 22, propozojmë që pika 2 të riformulohet si më poshtë: “Procedurat e shqyrtimit dhe dhënies së masave administrative, si dhe ankimit të vendimit”.

Fatmir Xhafaj – Biem dakord?

Vexhi Muçmataj – Dakord.

Fatmir Xhafaj – Neni 23 “Ekzekutimi i vendimeve”. Dakord?

Vexhi Muçmataj – Dakord.

Fatmir Xhafaj – Neni 24?

Vexhi Muçmataj – Në nenin 24 propozoj që...

Fatmir Xhafaj – Ka të drejtë relatori. Ju duhen 24 muaj për të nxjerrë akte nënligjore?

Vexhi Muçmataj – Propozojmë që të zvogëlohet afati i nxjerrjes së akteve nënligjore.

Fatmir Xhafaj – Çfarë do të bëni 24 muaj? 6 muaj, thotë zoti Majko, shumë i keni dhe ka të drejtë.

Ulsi Manja – Do pak afat, se janë biocide insekte.

Fatmir Xhafaj – Biem dakord ta vëmë “për gjashtë muaj”?

Vexhi Muçmataj – Dakord, gjashtë muaj.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Fatmir Xhafaj – Doni ta lini?

(Diskutime pa mikrofon.)

Dakord me nenin 24, me ndryshimin që iu bë. Neni 25 të kalojë te ligji “Për shëndetin publik”, se nuk shfuqizojmë me një ligj me një ligj tjetër. Bëni ndryshimin atje.

Neni 26 “Hyrja në fuqi”. Dakord?

Vexhi Muçmataj – Dakord.

Fatmir Xhafaj – Kush është dakord në tërësi? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Faleminderit!

E mbyllim këtu shqyrtimin e këtij ligji.

Faleminderit, zoti Zëvendësministër!

Punë të mbarë!



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

Dokument parlamentar

PROCESVERBAL

Datë 08.07.2015, ora 10:00

Drejton mbledhjen:

Fatmir Xhafaj – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

Votimi në tërësi i projektligjit “Për turizmin”.

Marrin pjesë:

Fatmir Xhafaj, Oerd Bylykbashi, Bashkim Fino, Dashamir Peza, Pandeli Majko, Ulsi Manja, Vasilika Hysi, Vexhi Muçmataj, Anila Agalliu, Petrit Vasili, Silva Caka, Eduard Halimi, Arben Ristani, Gent Strazimiri, Tahir Muhedini, Nard Ndoka, Pirro Lutaj.

Mungojnë:

Fatmir Mediu, Mhill Fufi, Tom Doshi.

Tani të votojmë projektligjin që mbyllëm dje “Për turizmin”.

Kush është dakord në tërësi? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Përgatitet për seancë edhe projektligji “Për turizmin”, meqenëse turizmi ka filluar, të paktën të shkojë edhe ligji.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

Dokument parlamentar

PROCESVERBAL

Datë 08.07.2015, ora 10:45

Drejton mbledhjen:

Fatmir Xhafaj – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

Projektligji “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 125/2013 “Për koncesionet dhe partneritetin publik dhe privat” të ndryshuar”.

Marrin pjesë:

Fatmir Xhafaj, Oerd Bylykbashi, Bashkim Fino, Dashamir Peza, Pandeli Majko, Ulsi Manja, Vasilika Hysi, Vexhi Muçmataj, Anila Agalliu, Petrit Vasili, Silva Caka, Eduard Halimi, Arben Ristani, Gent Strazimiri, Tahir Muhedini, Nard Ndoka, Pirro Lutaj.

Mungojnë:

Fatmir Mediu, Mhill Fufi, Tom Doshi.

Të ftuar:

Ervin Mete – zëvendësministër i Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë, dhe Sipërmarrjes.

Ardit Çollaku – këshilltar i ministrit të Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes.

Rovena Beqiraj – kryetare e Agjencisë së Trajtimit të Koncesioneve “ATRAKO”.

Gazmend Vehbi – specialist pranë Agjencisë “ATRAKO”

Fatmir Xhafaj – Vazhdojmë me projektligjin “Për koncesionet”.

Neni 1. Fjalën e ka relatori.

Ulsi Manja – Në germën “b” të këtij neni propozohet heqja e fjalës “konsiston” e për rrjedhojë, fjalia e parë e germës “b” të riformulohet si më poshtë “...”. Është nevoja ta lexoj?

Fatmir Xhafaj – Jo, nuk ka nevojë. Biem dakord?

Ulsi Manja – Në fjalinë e dytë të po kësaj germe të hiqet fjala “injektim”, se ndoshta termi më i përshtatshëm do të ishte “transferimet”.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Të hidhet një term më i përshtatshëm.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Fatmir Xhafaj – Ti e kishe te bujqësia.

Ulsi Manja – Dakord, Ervin?

Fatmir Xhafaj – Biem dakord?

Miratohet neni 1, me vërejtjen.

Ervin Mete – Shprehemi dakord për fjalën “konsiston”, por ndoshta për injektimet, për qartësi një term mund të jetë “kontributet” në kapital, se është më e përshtatshme, jo transferimet.

Fatmir Xhafaj – Dakord.

Neni 2?

Neni 3?

Ulsi Manja – Në nenin 3 të vendoset e plotë referenca në ligjin “Për burimet e rinovueshme të energjisë”, presje, në kllapa të citohet “nr. 138/~~2013~~, datë 02.05.2013” dhe treguesi i kapacitetit në megavatë të shkruhet në kllapa “megavat”, jo me shkurtime.

Fatmir Xhafaj – Biem dakord?

Miratohet neni 3, me ndryshimin.

Neni 4 “Koncesionet për hidrocentralet”.

Neni 5?

Neni 6?

Ulsi Manja – Në nenin 6 propozohet që germa “c” të riformulohet si më poshtë: “kryen publikimin e dokumenteve standarde të tenderit”.

Fatmir Xhafaj – Biem dakord?

Miratohet.

Neni 7?

Ulsi Manja – Fjalja e parë e këtij neni të ndryshohet si vijon: “Paragrafi i parë i nenit 12 numërohet 1 dhe pas tij shtohen pikat 2, 3, 4 me këtë përmbajtje”.

Po në këtë nen, në germën “ç” të pikës 2, fjala “negocimet” të zëvendësohet me fjalët “kryerjen e negocimeve”.

Fatmir Xhafaj – Besoj që edhe ministria është dakord, është vërejtje teknike.

Miratohet neni 7.

Neni 8? Dakord.

Neni 9? Dakord.

Neni 10? Dakord.

Neni 11?

Ulsi Manja – Në pikën 2 të këtij neni, fjala “konsulent” më duket ekuivalente me fjalën “këshilltar”. Nuk e di, konsulent/këshilltar... Propozoj të hiqet fjala “konsulent”.

Fatmir Xhafaj – Më mirë të hiqet fjala “këshilltar” se fjala “konsulent”.

(Diskutime në sallë pa mikrofon.)

Dakord, por në fakt unë jam për të kundërtën, sepse këshilltar dhe konsulent, siç njihet... konsulent është....

(Diskutime pa mikrofon)

E njëjta është.

(Diskutime pa mikrofon)

Po. Dakord.

Dakord?

(Diskutime pa mikrofon)

Neni 12. Dakord.

Neni 13.

Ulsi Manja – Kam diçka për nenin 13. E kam më tepër edhe për sqarim.. Në pikën 1 të këtij neni parashikohet se autoriteti kontraktues, në koordinim me njësinë e trajtimit të koncesioneve, partneriteteve publike- private, krijon Komisionin e Koncesionit të partneritetit Publik-Privat. Nuk është e qartë se çfarë përfshihet pas termit koordinim me autoritetin kontraktues për ngritjen e komisionit. Si do të bëhet caktimi i anëtarëve? Do të bëhet në mënyrë të përbashkët apo para caktimit të anëtarëve do të merret mendimi i kësaj njësie për krijimin e koncesionit? Desha një sqarim për këtë.

Fatmir Xhafaj – Po.

Ervin Mete – Neni vetë sqaron mënyrën se si ngrihet koncesioni. Nëse i referohemi pikës 3, thuhet: “Numri i anëtarëve në komision është jo më pak se pesë, nga të cilët jo më pak se dy janë nga njësia e trajtimit të koncesioneve dhe pjesa tjetër nga autoriteti kontraktor”.

Pra, përdoret termi që koordinon ngritjen e komisionit, sepse dy nga përfaqësuesit do të jenë nga njësia. Në rregullat dhe aktet nënligjore, pastaj, qartësohet proceduralisht, por mendoj se ligji vendos parimet dhe kërkesa është e qartë.

Fatmir Xhafaj – Po.

Bashkim Fino – ... ndërthuret pika 2 me pikën 3 të nenit 13, kur themi se anëtarët e komisionit duhet të jenë me profesion juristë, ekonomistë, profesione teknike dhe profesione nga fusha të tjera përkatëse, në varësi të objektit dhe karakteristikave të koncesionit partneritet publik privat. Pika 3 thotë– siç thatë edhe ju – pesë anëtarë, nga të cilët jo më pak se dy do të jenë nga agjencia e trajnimit. Si ndahen këta pesë anëtarë në raport me pikën 2 të këtij neni?

Ervin Mete – Komisioni duhet të ketë jo më pak se pesë anëtarë, pra mund të ketë edhe më shumë, dhe qartësisht duhet të ketë teknikë në përbërje. Nëse kemi një koncesion porti, nëse kemi një koncesion rruge apo infrastrukture, sigurisht që duhet të jenë inxhinierët dhe teknikët.

Njësia ka në përbërje ka vetëm ekonomistë dhe juristë, të cilët shohin qoftë anën procedurale juridike, qoftë kërkesat financiare apo teknike, sa u përket garancive financiare dhe elementëve që duhet të sqarohen në studimin e fizibilitetit. Kështu që, rast pas rasti, komisioni do të ketë në përbërje dy nga njësia, me profesion ekonomistë ose

juristë, ndërsa pjesa tjetër do të jenë përgjithësisht teknikë, por që mund të jenë edhe ekonomistë e juristë nga autoriteti kontraktor.

Fatmir Xhafaj – Në rregull. Po, zonja Hysi.

Vasilika Hysi – Faleminderit, zoti kryetar!

Unë kam një kërkesë për pikën 4 të nenit 13, ku flitet për anëtarët e komisionit, të cilët nuk duhet të kenë interes të drejtpërdrejt ose jo të drejtpërdrejt personal në asnjë prej aktiviteteve që përbëjnë konflikt interesi. Këtu do të sugjeroja t'i referohemi ligjit “Për konfliktin e interesit”, sepse në këtë ligj nuk flitet për interes personal, por flitet për një kategori personash që mund të jenë edhe të afërm. Prandaj them se duhet t'i referohemi fjalë për fjalë, ashtu siç e thotë ligji “Për parandalimin e konfliktit të interesit”. Nuk mundemi ne në këtë ligj të ngushtojmë rrethin e personave që duhet të shmangin konfliktin e interesit.

Ervin Mete – Dakord. Nuk e kemi prekur. Është ekzaktësisht siç është në ligjin aktual.

Fatmir Xhafaj – Po ç'ëndësi ka kjo? Ky s'është argument.

Ervin Mete – Jo, nuk ka asnjë. Pra, për ne...

Fatmir Xhafaj – Po pra, dakord! E mbyllni me një fjali.

Ervin Mete – Patjetër.

Fatmir Xhafaj – Po. Relatori? Zoti Mete, ju lutem!

Merrni pak mikrofonin!

Ulsi Manja – Në qoftë se kolegja Hysi kaloi te pika 4, unë propozoj që te pika 3 e po këtij neni, fjala “emërohet” propozoj të zëvendësohet me fjalën “krijohet”. “Mund të krijohet një komision i vetëm”, jo “emërohet një komision i vetëm”.

Pikën 4 të këtij neni, sigurisht që e kemi riformuluar, bashkë me propozimin e koleges Hysi, që të saktësohet çështja e konfliktit të interesit.

Fatmir Xhafaj – Lexoje riformulimin!

Ulsi Manja – Po.

Anëtarët e komisionit të koncesionit partneritetit publik-privat nuk duhet të kenë interes të drejtpërdrejtë ose të tërthortë privat në asnjë prej aktiviteteve që përbëjnë konflikt interesi, në përmbushje të detyrave si anëtarë të këtij komisioni, gjë të cilën ata e konfirmojnë me nënshkrimin e një deklarate që garanton se nuk ka konflikt interesi.

Fatmir Xhafaj – Në përputhje me ligjin për konfliktet e interesit, në respektim të...

Po. në rregull. Dakord, besoj.

Dakord me ndryshimin.

Neni 14? Dakord.

Neni 15? Dakord.

Neni 16?

Ulsi Manja – Në këtë nen, titulli i nenit të riformulohet dhe të bëhet: “procedura për dhënien e koncesioneve partneriteteve publike private”. Pra, të shtohet fraza “për dhënien e koncesioneve partneriteteve publike private”.

Fatmir Xhafaj – Po.

Ervin Mete – Zoti kryetar, ndjesë. Mundem?

Fatmir Xhafaj – Për çfarë është kjo njëherë?

Ervin Mete – Dakord me propozimin. Nuk kemi vërejtje, por nëse më lejoni, do të desha të kthehesha te neni 14, për të theksuar një moment që e kemi ne si propozim, nëse komisioni e pranon.

E kemi theksuar edhe gjatë prezantimit, që duam të limitojmë dorëzimin e ofertave të pakërkua minimaliste. Aktualisht rregullohet me VKM...

Fatmir Xhafaj – Është më poshtë kjo, më duket.

Ervin Mete – Jo, është në këtë nen.

Fatmir Xhafaj – Neni 14: “Studimi i fizibilitetit”.

Ervin Mete – Pikërisht. Praktikisht, neni aktual, vendosjen apo qartësimin e kushteve e kriterëve ia lë VKM-së, dhe VKM-ja sqaron llojet e studimit të fizibilitetit apo të ofertave që mund të prezantohen. Që ta vendosim në ligj, pra të mos e lëmë me VKM, ne do të donim ta theksonim se nuk do të pranohen oferta minimaliste. Pastaj, qartësohet me VKM se çfarë përbën ofertë minimaliste, çfarë përbën ofertë të zhvilluar. Por, është në linjë me gjithë ato që kemi thënë.

Fatmir Xhafaj – Në rregull.

Më duket interesante, me thënë të drejtën, por gjithsesi silleni riformulimin që ta shohim. Dakord!

Ervin Mete – Faleminderit!

Fatmir Xhafaj – Neni 16. Me vërejtjen që u bë nga relatori, dakord?

Ulsi Manja – Po për nenin 16, në pikën 3 të këtij neni, thuhet e në dhënien e koncesioneve autoriteti kontraktues mund të përdorë procedurën e hapur, procedurën e kufizuar ose procedurën me negociim, me shpallje paraprake të njoftimit të kontratës. Për të vazhduar procesin e përzgjedhjes së fituesit duhet të pranohet së paku një ofertë e vlefshme.

Dua të qartësohem: a mund të fillojë procedura e konkurrimit me një ofertë të vlefshme?

Fatmir Xhafaj – Domethënë vjen vetëm njëri me ofertë të pakërkuar, dhe ju thoni: “një është, kalo matanë!”

Ervin Mete – Jo kaq thjesht sa ç’e thoni ju, por...

Fatmir Xhafaj – Meqenëse janë më të koklavitura aty...

Ervin Mete – Po. Kjo i referohet mot-a-mot ligjit të prokurimit. Pra, i gjithë procesi i dhënies së koncesionit përfundon në prokurim. Nuk do të përdoren të gjitha format e prokurimit, që ndër to kanë edhe negociimin pa shpallje, por do të përdoren vetëm ato që janë format më të hapura. Pra, procedurë e hapur, procedurë e kufizuar ose procedurë me negociim, me shpallje paraprake të njoftimit.

Në ndryshimet që i janë bërë ligjit të prokurimit publik, që kanë kaluar edhe në këtë komision, është bërë ky ndryshim i fundit, që thotë: “Jo për efekt gare, po për efekt vlefshmërie, kur hapen ofertat, në qoftë se rezulton edhe një e vlefshme, konsiderohet garë dhe ecet përpara”. Duke qenë se i referohet rregullave të prokurimit, ndiqen të njëjtat rregulla edhe këtu.

Fatmir Xhafaj - Mirë. Unë propozoj që këtë ta lëmë. Unë personalisht, por edhe relatori, besoj, kërkojmë kohë. Herën tjetër – këtë e kam me këshilltarët – sillni edhe ligjin bazë, të plotë, sepse ashtu jemi më në gjendje të gjykojmë! Se edhe kjo “për të vazhduar procesin e përzgjedhjes së fituesit, duhet të pranohet së paku një ofertë e vlefshme”, do të thotë se s’ka më përzgjedhje. Derisa është një, kë do përzgjedhësh? S’ka më përzgjedhje. Ose ligji e ka gabim, këtë do ta shohim. Mot-a-mot, dakord. Mund të jetë kështu.

(Diskutim pa mikrofon)

Fatmir Xhafaj – Dakord. Nuk kam arsye që ta vë në diskutim që mund të jetë kështu, por ta shohim, se pastaj nuk më bën sens fjalia “për të vazhduar procesin e përzgjedhjes së fituesit duhet të pranohet së paku një ofertë e vlefshme. Po çfarë do të përzgjedhësh? Një është ai.

(Diskutim pa mikrofon)

Në një kuptim, ai është përzgjedhur automatikisht.

(Diskutim pa mikrofon)

Po, dakord. Ju e botoni në tri gazeta, e botoni në faqen e shtatëmbëdhjetë, me germa tetëshe, dhe thoni: E kam shpallur. Vetëm ky erdhi.

Ervin Mete – Përderisa i referohemi ligjit të prokurimit publik, jemi të detyruar të ndjekim rregullat e tyre.

Fatmir Xhafaj – Dakord.

Ervin Mete – Në qoftë se ndryshon atje, ndryshojmë ne këtu.

Fatmir Xhafaj – Jam absolutisht dakord. nëse është kështu, ne thjesht do të bëjmë një çekim, së bashku me propozimin që do të sillni ju me shkrim. Këtë do ta mbajmë si rezervë, për ta miratuar pastaj në tërësi.

Në rregull. Dakord me vërejtjen që është bërë.

Vazhdojmë me nenin 17. Në nenin 23 bëhen këto ndryshime.

Po.

Ulsi Manja – Në nenin 17, në pikën 2 të nenit: “Kriteret e vlerësimit për dhënien e kontratës së koncesionit” duhet të jenë të qarta, pasi formulimi “kriteret të ndryshme” të lidhura me objektin e koncesionit partneritetit publik privat në fjalë “si për shembull” është evaziv. Ne propozojmë formulimin e kësaj pike si më poshtë: “kriter vlerësimi për dhënien e kontratës së koncesionit partneritetit publik-privat, do të jetë oferta ekonomikisht më e favorshme, bazuar në cilësinë, që përfshin merita teknike, karakteristikat estetike e funksionale të mjedisit, kostot e drejtimit, kostot e efektivitetit, ofrimin e shërbimeve pas dorëzimit të produkteve dhe asistencën teknike, datën e dorëzimit dhe periudhën e dërgesës ose periudhën e përfundimit të punimeve, çmimin e shërbimit për përfituesit fundorë, shumën e tarifës së koncesionit”.

Pra, hiqen “kriteret të ndryshme, të lidhura me objektin e koncesionit”.

Fatmir Xhafaj – Ju, kështu e bëni një dispozitë shteruese këtë. në rregull, në qoftë se është e pranueshme. Sepse ata, në qoftë se ngelet kështu, duhet të thonë diçka tjetër. Për shembull, janë dakord ta heqin këtë, e t’i përcaktojnë...

Ulsi Manja – “Si për shembull” është shumë evazive.

Fatmir Xhafaj – Ta bëjmë me slider pastaj.

Ervin Mete – Për natyrën shumë komplekse, diverse të partneritetit publik-privat është e domosdoshme që të mos jenë shteruese kriteret mbi të cilat vlerësohet, sepse mundet që të kemi një partneritet, për vlerësimin e të cilit duhet të përfshijmë kritere përtej atyre që mund të jenë shteruese këtu.

Fatmir Xhafaj – Dakord, por rrit shumë marzhin e subjektivitetit.

Ervin Mete – Ju lutem! Është formulim i direktivës. Pra, direktiva vetë e lë të gjerë marzhin e kritereve.

Fatmir Xhafaj – Edhe “si për shembull” e ka direktiva?

Ervin Mete – “Si për shembull” nuk ju them dot, por është e sigurt se nuk është shteruese.

Fatmir Xhafaj – Po mirë, meqenëse ju nuk na e thoni dot, silleni edhe direktivën, dhe ta përshtatim.

Dakord, por edhe ky marzh subjektiviteti, domethënë se mua s’ më pëlqen, ty të pëlqen. Lë shumë marzh subjektiviteti. Nëse thua “si për shembull”, “janë disa, por janë edhe disa të tjera” thotë nesër autoriteti kontraktues”.

Ervin Mete – Ju lutem, që të jemi të qartë për çfarë kemi propozuar. Aktualisht, ligji ka dy mënyra vlerësimi: një është vetëm çmimi, dhe dy është kjo që është....

Fatmir Xhafaj – Kriteret shtesë.

Ervin Mete – Po. Dhe ne kemi thënë se nuk do të përdorim vetëm çmimin. Pra, po heqim mundësinë e përdorimit dhe po e lëmë – nuk e kemi riformuluar – dhe po e lëmë...

Fatmir Xhafaj – Pavarësisht se e bën më subjektive, por e bën më të sigurt ofertën, zgjedhjen. Dakord jam.

Ervin Mete – Jo gjithmonë ecet me logjikën e prokurimit publik, që vetëm çmimi më i mirë e bën më të mirë të gjithë kompleksitetin e partneritetit. Pra, ky është

ndryshimi: kemi hequr rastin kur vlerësohet vetëm me çmim dhe kemi lënë vlerësimin duke përdorur kritere të tjera. nuk ka ndryshuar asgjë nga ana jonë.

Fatmir Xhafaj – Ju keni përdorur një kriter interesant: “karakteristikat estetike” për shembull. Është interesante.

Ervin Mete – Po, patjetër...

Fatmir Xhafaj – Për shembull, mua më pëlqen. Këtij s’i pëlqen. “kritere estetike” e keni vënë.

Ervin Mete – Tani, përderisa përdoret gjerësisht, do ta përdorim edhe ne. Ky është ligji që është hartuar në 2013-ën, nga SIGMA, për të reflektuar direktivën.

Fatmir Xhafaj – Po s’është argument ky.

Dakord, ta lëmë. Bie dakord me ju në një gjë. Ju keni një të drejtë, kur parashtroni që duhet parë edhe përqasja me direktivën. Biem dakord që edhe kjo të jetë një gjë që duhet të shikohet me direktivën. Në qoftë se direktiva është...

Po.

Ulsi Manja – Edhe nëse hiqet fjala “si për shembull”, formulimi që propozojmë ne ka prapë doza subjektivizmi në mes, sepse edhe po t’i referohemi meritave teknike, çështje subjektivizmi është vlerësimi i meritave teknike. Edhe kjo që ju thatë “karakteristikat estetike”. Edhe po të formulohet kështu siç e propozojmë ne, pa e parë përshtatjen me direktivën, përsëri ky nen nuk është shterues. Nuk është shterues për komisionin që do të vlerësojë koncesionin e partneritetit publik privat. Gjithsesi, të vijë direktiva dhe ta shohim

Fatmir Xhafaj – Dakord.

Ervin Mete – Nëse mundem, kryetar, për ta bërë edhe më elegante.

Bazuar në kritere të ndryshme, të lidhura me objektin –kjo shtë normale – dhe heqim “në fjalë” dhe “si për shembull”, dhe ngelet: “Objekti i partneritetit publik privat që përfshin meritat teknike...”

Jo, thatë ta heqim komplet pjesën “kritere të ndryshme” dhe vetëm të listojmë kriteret.

Fatmir Xhafaj – Jo, jo, s’e thashë unë.

Ervin Mete – Po, po.

Pra, nëse e bëjmë më elegante në këtë formë, besoj se është e pranueshme.

Fatmir Xhafaj – Po, dakord.

Në rregull. Iku edhe neni 17, me sugjerimet dhe vërejtjet që u bënë.

Neni 18. Dakord.

Neni 19.

Domethënë, këtu hyn përsëri ajo që, propozimi i pakërkuar ka një bonus, me një fjalë. Por ne, me hidrocentralet, e hoqëm këtë. Një nga problemet që ngritëm kur ishte pozicioni i pakërkuar te hidrocentralet, ishte kjo çështja e bonusit, subjektiviteti. Kemi folur me të madhe për këtë gjë.

(Diskutime pa mikrofon)

Po, po. Ne e kemi hequr, se e shfuqizojmë. Po e shfuqizojmë.

Ervin Mete – Pra, ajo që ka ndodhur është: edhe pse ky ligj ishte ligji kuadër, jepte një përjashtim për koncesionet, të cilat ishin fusha e vetme që trajtohej me bonos dhe me rregulla të veçanta. Ajo që po themi është: duke qenë se tani bonusi do të aplikohet më gjerësisht, atëherë edhe koncesionet do të aplikohen e trajtohen sipas këtyre rregullave. Jo me rregulla të mëvetme. I fut brenda kuadrit të ligjit, por bonusi aplikohet për të gjithë.

Fatmir Xhafaj – A nuk është deponim gare ky? Sepse tjetrit i ke dhënë një pozicion më të favorshëm në vlerësim.

Ervin Mete – Është një nga format e njohura të vlerësimit

Fatmir Xhafaj – Dakord, dakord, por a është deponim gare? Dikush është më i avantazhuar.

Ervin Mete – Është praktikë e njohur ndërkombëtare. Ka disa forma se si avantazhohen. Një është me bonusin, një është ajo që njihet si *swiss challenge*, një është ajo që quhet *best in final oferte*...

Fatmir Xhafaj – Po, po e di çfarë ka ndodhur? Jam dakord. Jam dakord, por në praktikën tonë, ngaqë s'e kemi mbështetur mirë, çfarë ka ndodhur? I është thënë se do të ta japim ne këtë; e ka sjellë njëri me ofertë të pakërkuar, ka marrë dhjetëshin plus dhe u kanë thënë atyre të tjerëve: ky e ka sjellë vetë ofertën.

(Diskutime pa mikrofon)

Është ekzakt kjo që thotë Nardi, është ta korruptosh që në fillim. Pse? Sepse s'e ke mbështetur këtë procedurë, që ti ta kesh njoftuar publikisht e ët tjera e të tjera. E ai

thotë: erdhi ky dhe e solli vetë. Ka avantazhin. E unë të jap dhjetë, sepse ai e di ndërkohë. I kanë thënë: “shiko, sille një ofertë ti, sepse kështu ashtu”. Ka ndodhur. Ka ndodhur me hidrocentralet.

Jo, nuk ka ndodhur, thotë zonja e Ministrisë së Energjisë, por në fakt kështu i kemi dhënë.

Ervin Mete – Nëse më lejoni...

Fatmir Xhafaj – Pa hajde e ulu, ministria...

Ervin Mete – Mundem?

Fatmir Xhafaj – Po, po.

Ervin Mete – Të trajtojmë dy çështje më vete. Pra, një është lejimi dhe trajtimi i propozimeve të pakërkuara, të cilat pranohen gjerësisht si të nevojshme në ekonomi, në zhvillim, që nuk i kanë të plota kapacitetet për të përgatitur vetë studime fizibiliteti dhe ia kalojnë koston e riskun privatit...

Fatmir Xhafaj – Jam shumë dakord.

Ervin Mete – Së pari. Së dyti, është çështja e kompensimit, në thonjëza, të këtij risku dhe kostoje, dhe kostoja mund të jetë e konsiderueshme, që u jepet atyre që marrin përsipër të përgatisin...

Fatmir Xhafaj – Dakord jam

Ervin Mete – Ju lutem.

Fatmir Xhafaj – Më fal.

Ervin Mete – Siç ju thashë, ka disa forma se si trajtohet bonusi. Aktualisht ne po bëjmë ndryshimin që nuk lejojmë formën minimale të propozimit.

Fatmir Xhafaj – Dakord.

Ervin Mete – Që do të thotë: do të vijë propozim me prifizibilitet të avancuar ose me studim fizibiliteti të plotë, të cilat nga ana e tyre kërkojnë kosto të konsiderueshme dhe marrje risk përsipër nga ana e investitorit. Pra, nuk trajtojmë më thjesht me një propozim minimal. Në këto kushte, nga ana e atyre që propozojnë, si më ftuesi, po themi, konsiderohet bonusi. Ajo çfarë kemi sot – sepse e kemi sot një formulë kompensimi – që është një kompensim nëse ai nuk del ftues dhe i kompensohet e gjithë vlera e projektit, që mund të shkojë me miliona euro, jo vetëm që është vështirësish e aplikueshme për autoritetet kontraktore e për shtetin dhe mund të lërë shkak për abuzim,

në sensin e paraqitjes së shumë propozimeve, thjesht për të përfituar kompensimin, sepse synon të mos dalë fitues, por edhe nuk ka rezultuar aq invaiting, aq ftues. Kjo është logjika me të cilën ne e kemi prezantuar.

Fatmir Xhafaj – Unë jam praktik. Jam shumë dakord me arsyetimin tuaj. Nuk i heq asnjë presje për një leksion shumë të mirë. Por, teorikisht, ju keni shumë të drejtë. Tani, e marrim në praktikë këtë. Për ta mbrojtur këtë, sepse, ky që ka këtë status, që merr këtë status, merr një pozicion të avantazhuar ndaj një propozimi konkret, ndaj një të drejtë konkrete dhe në garën e mundësisë së konkurrimit. E merr apo s’e merr? E merr. Kjo ka qenë një kritikë që ne e kemi bërë kur ka qenë rasti i hidrocentraleve. Tan, si e mbrojmë këtë gjë? Sepse, në një ditë të bukur, investitori A e gjen se ka një komunikim në ministri, që kjo mund të jepet me koncesion, dhe vjen bën një studim fizibiliteti. Këtë studim, nëse do ta dinte, do ta bënte edhe B-ja, edhe C-ja, edhe D-ja. Këtë, a kemi mundësi ta mbështesim? Për t’ia dhënë këtë mundësi edhe C-së, edhe D-së, që ministria të shpallë publikisht: unë kam interes një dy tre, lejoj në këtë gjë dhe, përveç A-së, që e gjeti ngaqë ishte i zoti si biznesmen, le të vijë edhe B-ja, edhe C-ja, edhe D-ja, që s’ishin aq të zotë në sirtarët e ministrisë. Kjo është logjika ime. Nuk e di a më kuptoni.

Ervin Mete – Po, ju kuptova.

Fatmir Xhafaj – Domethënë, parimisht ju keni shumë të drejtë. Unë them: më mbro nga zyrtarë të lartë të shtetit që janë abuzivë. Mos e lidhni këtë me mua e me tjetrin e tjetrin. Ne sot jemi, nesër s’jemi.

Ervin Mete – E qartë fare.

Fatmir Xhafaj – Ne do të sjellim një ligj që është i qëndrueshëm, që u jep mundësi të gjithëve, që është i barabartë për të gjithë, që hap një garë të ndershme dhe jep barazi në garë, mundësisht. A, kur nuk ka mundësi tjetër, janë shpallur këto, janë këto mundësi e askush tjetër nuk vjen, ndërsa ky vjen dhe ka mundësi ta bëjë edhe këtë, është i avantazhuar vërtetë, sepse ka bërë goxha, atë që thoni ju e të tjera e të tjera. Por, ti s’ke pse ma përjashton mua këtë gjë. E mori edhe B-ja, C-ja e D-ja, kjo është logjika. Në qoftë se kjo është e mjaftueshme – dhe unë besoj shumë tek ajo që përfaqësoni ju si individ; përfitoj nga rasti ta them këtë që kam një respekt të veçantë edhe për dijet edhe për ndershmërinë tuaj si individ – por nuk është e mjaftueshme as garancia juaj, as imja dhe e askujt tjetër. këtu nuk japim garanci individuale. Duhet të jetë ligji ai që jep garanci, dhe

garanci të qëndrueshme. Sepse thotë: unë ju garantoj juve. Ne e kemi pasur tetë vjet këtë histori me njërin që thoshte: unë i garantoj shqiptarët se do të jetë kështu. Dhe Sudja vu. Edhe këtu, pavarësisht cilësive tona individuale, ne nuk mund të dalim të garantojmë disa kërkesa të tregut. Është ligji ai që duhet t'i garantojë. Pastaj dalin nëpunësit tuaj të vegjël atje, që bëjnë pazare nga mëngjesi deri në darkë.

Kjo është logjika, mendoj unë. Megjithatë, ta lëmë këtë histori, se kam parasysh historinë e hidrocentraleve. Unë bëj pjesë tek ata që mendojnë, jam ligjvënës dhe kam të drejtë ta them, meqenëse do të ndërhysh: historia e hidrocentraleve ka qenë një histori korrupsioni në këtë vend, dhe vazhdon të jetë një histori korrupsioni. E thënë drejtpërdrejt prej meje. Ky është mendimi im. Unë jam ligjvënës dhe do ta them këtë gjë. Pavarësisht retorikës që thuhet dhe punës së mirë që është duke u bërë – për hir të së vërtetës – për t'i ngushtuar këto hapësira korruptive. Por këto kanë qenë format. Ofertë e pakërkuar, bonusi, kjo e kjo e kjo. E thoshin të gjithë: me ligjin. Por korrupsion me ligj është ky.

Ne tani jemi duke bërë një reformë për drejtësinë. E di ti se cila është një nga pikat më të forta që kemi, ekspertët, jo ne, dhe kanë bërë shumë mirë – kam lexuar dje një material prej tyre – që është se si të mbyllim shtigjet e ligjit. Si t'i mbyllim shtigjet e ligjit, që ligji vetë të mos e lejojë nëpunësin të bëjë korrupsion.

Nejse. Ndjesë, sepse po të ishte kështu, që me fjalime të mbyllej korrupsioni, do të ishte mirë.

Po, zoti zëvendësministër.

Ervin Mete – Shkurtimisht, vetëm dy pika. Shumë faleminderit për konsideratën! Në momentin që vjen propozimi i pakërkuar, vlerësohet nga komisioni dhe hapet në garë. Përgjithësisht, edhe pse është deri në dhjetë pikë, pikët që janë dhënë shkojnë maksimumi në dy deri në tre pikë. Por, jepet ky marzh sepse, për shembull, në se do të kemi një projekt porti, për të cilin mund të shkojë edhe mbi dhjetë milionë euro një studim i plotë fizibiliteti, atëherë i jepet incentivë për ta nxitur që ta propozojë, sepse përndryshe do të duhet që ta marrë përsipër vetë shteti.

Fatmir Xhafaj – Të bëjë studimin e fizibilitetit.

Ervin Mete – Po.

Fatmir Xhafaj – Dakord. deri këtu jemi dakord.

Ervin Mete – Në fund, në varësi të cilësisë së studimit të fizibilitetit, ky komision vlerëson se sa pikë plus mund të marrë, por hapet garë për të gjithë. Dy apo tre pikë, sigurisht që është një avantazh që reflekton propozimin dhe koston që ka marrë përsipër, por mund të mos jetë një avantazh determinues për garën.

Fatmir Xhafaj – Edhe një herë, nuk heq asnjë gjë nga ato që thoni ju, absolutisht. Ajo që them unë është: në lidhje me portin e jahteve, që morët ju si shembull e që po e marr edhe unë, në vijim të logjikës suaj, pra porti i jahteve, A-ja pati mundësi dhe e bëri studimin, por a ia kemi dhënë mundësinë edhe B-së, edhe C-së, edhe D-së që ta bëjnë studimin e fizibilitetit? Pse?

(Diskutim pa mikrofon)

Po më fal një minutë! Mbasi ky e ka sjellë ofertën e pakërkuar. Ky e ka sjellë, e pastaj hapet konkurrimi. Hap përpara, dhe kush e bën këtë mundësi le ta sjellë.

Ervin Mete – Ka një element. Në qoftë se identifikimin e projektit e bën autoriteti kontraktor, kjo quhet hapësirë e ezauruar. Pastaj duhet ta vazhdojë autoriteti kontraktor dhe t'i ftojë në garë, dhe nuk ka më bonus. Bonusi jepet vetëm për ato – edhe ligji aktual shprehet qartësisht, edhe direktiva – projekte të cilat nuk janë identifikuar nga autoriteti kontraktor. Pra, jepet një propozim jashtë atyre që mund të ketë listuar autoriteti kontraktor.

Fatmir Xhafaj – Dakord. Këtë po them unë. Sepse ai vjen tek unë –te personi në zyrën tuaj – dhe i them: “shiko, sill një studim fizibiliteti shpejt e shpejt, sepse do ta japim këtë”. E ai vjen e thotë: “e bëra studimin e fizibilitetit”. Por atë studim fizibiliteti mund ta kishte bërë edhe një tjetër, mjaft që ta dinte. Ka pasur një akses të brendshëm. Ky është problemi. Janë shtigje korruptive.

Po.

Rovena Beqiraj – Po flas për HEC-et, por edhe për procedura të tjera janë procedura shumë të gjata, të cilat në qoftë se do të bëhej një minigarë, nuk do të ishte e para që do të zgjaste pa fund kohën, sepse do konsiderohej një tjetër prokurim ose një tjetër tenderim për projektin e fizibilitetit, gjë e cila në të gjitha rastet ka shumë kosto. Sigurisht ka kosto projekti, ka kosto për marrjen e lejeve, sepse para se të vijmë deri në identifikim, do të shprehen shumë organe të tjera. Nuk është vetëm Autoriteti Kontraktor, i cili kalon në një oponencë teknike shtetërore pasi edhe oponenca vetë ka një kosto

goxha të konsiderueshme. Në këtë moment i bie, që pasi është bërë projekti i parë, që është identifikimim, të bëhet edhe një minigarë tjetër, të kalojnë përsëri dhe janë shpenzime të kota të të gjithë operatorëve, ndërkohë që, të gjithëve u jepet shansi dhe mundësia për të konkurruar në ofertën më të mirë të mundshme pasi nuk është se kufizohet identifikimi i një projekti.

Nëse ka dy kuota të caktuara, hapet pellgu dhe nëse ka interes sigurisht që vlerësohet projekti më optimal. Kështu që, do të ishin kosto shumë të tepërta për operatorët ekonomik që do të bënin edhe ata studimin e fizibilitetit që tek e fundit prapë në një subjektivizëm do çonte dhe do të kishim një ligj tjetër, për të cilin ne do të bënim krahasimin e ofertave të fizibilitetit, kush do ishte i pari dhe kush i dyti dhe si do t'i trajtonim ata.

Fatmir Xhafaj – Dakord! Unë ruajta qëndrimin tim deri në miratimin në tërësi të projektligjit, pa të sjellë diçka për këtë gjë.

Neni 20, dhe këtu kemi mbajtur një qëndrim lidhur me procedurën e ankimit rregullojeni te ligji “Për prokurimin publik”.

Neni 21...

Ulsi Manja – Lidhur me nenin 20. Përderisa ky nen në pikën 8 parashikon ankimin në gjykatë, unë propozoj që ose të rishikohet titulli te procedura e rishikimit administrativ ose në gjykatë ose të ndahet në dy nene, një nen të parashikohet procedura e rishikimit administrativ dhe në një nenin 20/1 të jetë procedura e ankimit në gjykatë.

Fatmir Xhafaj – Po a është kjo në ligjin “Për prokurimin publik”? E bëra edhe herën e parë këtë pyetje .

Ervin Mete – Gjithçka që ka ndryshuar janë vetëm afatet, të cilat këtu janë disi më të shkurtra se atje, sepse është një nga qëllimet kryesore.

Fatmir Xhafaj – Dakord, ndryshojeni atje tek ai ligji! Te ligji “Për prokurimin publik” do të bëni ndryshimin “Për turizmin”, bëni edhe këtë që të ketë një logjikë.

Ervin Mete – Një minutë, nëse mundem! Ky ligj shprehet në këtë formë dhe logjika është në këtë formë që do të aplikohen rregullat e prokurimit publik për aq kohë sa ky ligj nuk parashikon ndryshe sepse ka një sërë elementesh të prokurimit publik që mund të kërkojnë një trajtim të ndryshëm për koncesionet, siç është për shembull pjesa e çmimit që sapo kaluam. Edhe në këtë rast ne kemi marrë pjesën e rishikimit nga ligji

“Për prokurimet publike”, por gjykojmë që afatet janë më të përshtatshme në këtë formë. Edhe direktivat i rregullon vetë këto afate edhe ky afati...

Fatmir Xhafaj - Nuk është argument direktiva për këtë gjë, sepse direktiva përthyer te ligji kuadër, i cili ka epërsi mbi këtë, te ligji rregullator i fushës.

Ervin Mete – Në rregull! Këtu ne kemi zgjedhur që të mos i referohemi më atij ligji por të bëjmë procedurën.

Fatmir Xhafaj – Në rregull Ulsi, shikoni të dy variantet, edhe ndarjen me dy variante dhe kalimin atje.

Neni 22, dakord!

Neni 23, dakord!

Neni 24, dakord! Lidhur me afate sa e keni mundësinë? A janë shumë? Sa doni 3 apo 4 muaj?

Ervin Mete – Nëse më lejoni! Aktet nënligjore të këtij ligji janë sepse është një ligj në fuqi dhe ne do të bëjmë mendime të akteve.

Fatmir Xhafaj – Sa afat doni?

Ervin Mete – Ne mund t’i nxjerrim për tre muaj.

Fatmir Xhafaj – Tre muaj? Dakord!

Ervin Mete – Nuk e di nëse është korrekte sot për nxjerrjen e akteve nënligjore që janë të reja, por aktet në fakt janë dhe ne do t’i amendojmë.

Fatmir Xhafaj – Pra, për amendimin, për rishikimin e akteve doni tre muaj?

Ervin Mete – Ne mund t’i nxjerrim për tre muaj.

Fatmir Xhafaj - Ky është një detyrim kushtetues nuk është se po e shpikin ne , se po ta shpiknim ne nuk do të shkonim te zyrtarët e patentave sot.

Neni 25? Dakord në tërësi! Me vërejtje duke i dhënë edhe mundësi para se të kaloj. Ka kundër? Nuk ka. U lanë ato nene që u lanë dhe nëse nuk biem dakord do të kthehemi komisionit dhe nëse biem dakord do ta kalojmë me vërejtjet që u bënë dakord zoti zëvendësministër? Shumë faleminderit dhe prej jush për bashkëpunimin dhe besoj se lufta kundër korrupsionit nuk është detyrë vetëm e ministrit Çuçi, por edhe ministrit Ahmetaj dhe ekipit të tij. Gjithë të mirat! Mirupafshim!



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

Dokument parlamentar

PROCESVERBAL

Datë 08.07.2015, ora 11:30

Drejton mbledhjen:

Fatmir Xhafaj – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

Projektligji “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”.

Marrin pjesë:

Fatmir Xhafaj, Oerd Bylykbashi, Bashkim Fino, Dashamir Peza, Pandeli Majko, Ulsi Manja, Vasilika Hysi, Vexhi Muçmataj, Anila Agalliu, Petrit Vasili, Silva Caka, Eduard Halimi, Arben Ristani, Gent Strazimiri, Tahir Muhedini, Nard Ndoka, Pirro Lutaj.

Mungojnë:

Fatmir Mediu, Mhill Fufi, Tom Doshi.

Të ftuar:

Plarent Ndreca - Sekretar i Përgjithshëm pranë Ministrisë së Arsimit dhe Sportit

Alekasandër Xhuvani - anëtar i Komisionit të Arsimit të Lartë

Erzen Tola - drejtor i Drejtorisë Juridike pranë Ministrisë së Arsimit dhe Sportit

Erjon Muharremaj - këshilltar Juridik i Komisionit të Arsimit të Lartë.

Fatmir Xhafaj – Fillojmë me pikën e tretë të rendit të ditës dhe është projektligji: “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në Republikën e Shqipërisë”. Kemi votuar projektligjin në parim dhe tani kemi shqyrtimin nen për nen.

Kemi të ftuar nga Ministria e Arsimit dhe Komisioni i Arsimit të Lartë, sepse besoj se komisioni është një ent i pavarur në funksionin e tij. Nga Ministria e Arsimit është sekretari i Përgjithshëm, zoti Ndreca, së bashku me drejtorin e Drejtorisë Juridike, zotin Tola.

Nga Komisioni i Arsimit të Lartë, është zoti Aleksandër Xhuvani. Profesor, faleminderit që jeni i pranishëm!

Mund të fillojmë! Zonja Hysi është relatore. Na nderon me pjesëmarrjen e saj profesoreshë Hafizi, e cila është relatore te komisioni tjetër, por edhe pa qenë relatore atje për ne është nder që e kemi këtu.

Vazhdojmë me nenin 1. Misioni i arsimit të lartë.

Zonja Hysi, keni fjalën!

Vasilika Hysi – Faleminderit, zoti Kryetar!

Lidhur me nenin 1, ka vetëm një riformulim të pikës a) të këtij neni ku sugjerohet të formulohet: “Arsimi i lartë është e mirë dhe përgjegjësi publike. Arsimi i lartë ka për mision të krijojë, të zhvillojë, të përcjellë dhe të mbrojë dijet përmes mësimdhënies, kërkimit shkencor si dhe të zhvillojë artet, të nxisë dhe të zhvillojë edukimin fizik dhe sportet”.

Fatmir Xhafaj – Ka ndonjë që e konteston këtë pikë te nenit 1?

Plarent Ndreca – Ideja është nëse ju e gjykoni të na jepen arsyet për çdo lloj ndryshimi apo propozimi dhe pse duhet ndryshuar, që ne ta kuptojmë.

Fatmir Xhafaj – Nëse nuk e kuptoni thoni: “Nuk e kuptojmë!”. Ne nuk japim llogari për ndryshimet!

Plarent Ndreca – Nuk e kisha në këtë aspekt!

Fatmir Xhafaj – A keni kontestim për këtë ndryshim?

Plarent Ndreca – Nuk kemi.

Fatmir Xhafaj – Në rregull! Neni 1 miratohet!

Neni 2. Qëllimi i ligjit.

Vasilika Hysi - Lidhur me nenin 2 nuk ka ndryshime!

Fatmir Xhafaj – Në rregull! Neni 2 miratohet!

Neni 3. Autonomia e institucioneve të arsimit të lartë.

Vasilika Hysi - Lidhur me nenin 3 unë kam disa paqartësi edhe në formë pyetjeje dhe konkretisht të germa c) e këtij neni, ku thuhet: “Autonomia financiare garantohet nëpërmjet të drejtës për të caktuar rregullat e brendshme të financimit dhe të shpërndarjes së të ardhurave sipas veprimtarisë dhe nevojave të institucionit.

Pyetja ime për përfaqësuesin e ministrisë dhe për grupin e ekspertëve që kanë hartuar këtë projektligj është: Në këtë përcaktim përfshihet edhe e drejta që kanë institucionet publike që të administrojnë vetë të ardhurat?

Në mendimin tim të përcaktosh rregullat e brendshme të financimit dhe shpërndarjes së të ardhurave nuk do të thotë që automatikisht ke të drejtë për t'i administruar këto të ardhura? Ky është shqetësimi im!

Fatmir Xhafaj – Faleminderit, zonja Hysi! Bëhet fjalë për germën c) të nenit 3 dhe kishit një sugjerim që pas germës c) të shtohet edhe germa ç) apo jo? Kjo është logjika, apo jo?

Po, zoti Ndreca!

Plarent Ndreca – Gjykoj që kjo është e rregulluar dhe është në neni 106 të ligjit dhe është i përcaktuar qartë edhe ky shqetësimi i zonjës Hysi, ku thuhet qartësisht se: “Institucionet e arsimit të lartë kanë të drejtën të përdor të ardhurat e krijuara sipas nevojave të institucionit... Kështu që, gjykoj se është ezauruar ky moment.

Fatmir Xhafaj - Dakord, por, meqenëse këtu janë principet, në parim nuk...

Plarent Ndreca – Nuk gjykoj se është një ndër parimet ky, sepse është vetëkuptuar që për sa kohë ka hapësira për të krijuar..

Fatmir Xhafaj – Një minutë, e para, ky nen është nen parimor, sepse ka disa principe mbi të cilat organizohet arsimi i lartë. Kjo që po themi, për derisa është te neni 106, çfarë ju bën ju se është këtu, se doni të kundërshtoni, apo?

Plarent Ndreca – Ne nuk na bën asgjë, por çështja është që nëse po flasim për parime, atëherë..

Fatmir Xhafaj - Nga pikëpamja teknike ose legjislative?

Plarent Ndreca - Nuk më duket parimore, pra ky është një element administrativ menaxheria, i cili nuk mund të vihet te neni 3. Neni 6 ku përcaktohet gjerësisht autonomia financiare si element, 106 po, po element i menaxhimit të ..

Fatmir Xhafaj - Disa principe ne nenin 3, që i hapin rrugë konkretizimit në nenet e tjera.

Plarent Ndreca - Edhe kjo është e konkretizuar

Fatmir Xhafaj – Atëherë, zonja Hysi po thotë, le të jetë edhe ky një princip dhe le të konkretizohet me nenin 106.

Plarent Ndreca – Ne nuk jemi dakord me këtë pjesë.

Fatmir Xhafaj – Ka një gjë, që nëse keni ardhur me idenë që ju nuk jeni dakord dhe ne jemi dakord, mund ta bëj edhe ndryshe. Ju lutem, do të them një gjë, të jesh pak i kujdesshëm në gjuhën që përdor me komisionin, se unë nuk e toleroj. Ne jemi kolegë, bashkëpunojmë, kështu që..

Plarent Ndreca – Unë po flas në mënyrë shumë institucionale, kam ardhur të përfaqësoj qeverinë shqiptar dhe nuk po përdor gjuhë joetike dhe të palejueshme. Unë thashë mendimin tim, gjykoj që nuk është në nenin 3 të thuhet një gjë e tillë, sepse ky ligj ka një strukturë dhe, nëse do të ndërhyjmë në çdo moment, në çdo nen, gjykoj që kjo del nga logjika e nenit 3. Pra nuk është parimore.

Fatmir Xhafaj – Po nëse nuk do të ndërhyjmë, atëherë ta votojmë këtë.

Plarent Ndreca – Jo, ju lutem, unë po them mendimin tim. Pra, neni 3 ka një logjikë që janë parimet e funksionimit të Institucionit të Arsimit të Lartë. Mendoj se ky nuk është një ndër parimet, ky është nënelement, i cili është rregulluar te një nen tjetër. Ky është mendimi im.

Fatmir Xhafaj – Atëherë, cili është argumenti?

Mimoza Hafizi – Unë mendoj se meqë ju e pranoni se Institucioni i Arsimit të Lartë ka të drejtë të përdorë të gjitha të ardhurat e krijuara, atëherë neni 3 germa “c” mbetet e cunguar nëse nuk shtohet edhe “ e drejta e përdorimit të të gjitha të ardhurave”, pavarësisht se është shtuar te neni 106. Pra, neni 3 germa “c” është e cunguar. Meqenëse institucionet do ta kenë këtë të drejtë, pse të mos shkruhet totalisht aty ku është e përcaktuar e drejta e institucionit e cila është përcaktuar, siç keni thënë ju, për të caktuar rregullat e brendshme, të financimit dhe shpërndarjes së të ardhurave, ndërkohë që

pranoni se edhe përdorimi i të gjitha të ardhurave të krijuara nga institucioni, neni 3 germa “c”, mbetet i cunguar, nëse nuk shtohet edhe germa”c”. Atëherë ose të bashkohen germa “c” dhe “ç” bashkë, ose të dalë germa”c” në vete.

Fatmir Xhafaj –Po.

Vasilika Hysi – Unë kam një pyetje për zotin Xhuvani, a është autonomi financiare vetëm përcaktimi i rregullave të brendshme të financimit, vetën përcaktimi i rregullave të shpërndarjes apo edhe e drejta e përdorimit të të ardhurave?

Aleksandër Xhuvani – Janë të dyja së bashku. Do të thotë, këtu në autonominë financiare në paragrafin e tretë përcaktohet rregulli i përgjithshëm. Te neni 106 thuhet: “Të gjitha të ardhurat e krijuara për Institucionet e Arsimit të Lartë, përdoren prej tyre dhe pjesa e papërdorur mbahet për vitin pasardhës”. Pra sipas këtij parimi Institucioni i Arsimit të Lartë ka të drejtë të përcaktojë me rregulloren e brendshme, mënyrën e përdorimit të të ardhurave në bazë të autonomisë së universitetit. Pra, të ardhurat që krijon institucioni, nuk mund t'i përdorë për gjëra të tjera, veçse për përmbushjen e misionit. Më poshtë sqarohet rregulli që unë kam të drejtë. Kjo është autonomia. Autonomia është mënyra e pavarur në një shkallë të madhe të pavarësisë së përdorimit të , të të ardhurave dhe kjo përcaktohet këtu, më pas flitet për të gjitha të ardhurat. Pra, parimi i autonomisë është ky, përdor një farë autonomie apo pavarësie në përdorimin e fondeve, pa ndërhyrje të panevojshme të qeverisë.

Vasilika Hysi – Shumë faleminderit për sqarimin, ndajmë të njëjtin mendim, pra ne themi që autonomia financiare garantohet nëpërmjet të drejtës për të caktuar rregulla të brendshme financimi dhe, kur thoni të shpërndarjes së të ardhurave, janë rregullat e shpërndarjes, por edhe të përdorimit. Atëherë, mund ta vëmë fjalën përdorim. Kjo është.

Fatmir Xhafaj – Faleminderit!

Atëherë vazhdojmë me pikën tjetër? Cili është mendimi juaj?

Vasilika Hysi - Te pika 4 është autonomia organizative dhe e përzgjedhjes, që “garantohet nëpërmjet së drejtës”, thuhet në germën “ç”, për të caktuar në mënyrë të pavarur numrin e personelit kriteret, procedurat e përzgjedhjes së tij dhe për të përcaktuar pagat e personelit. Ne, Institucionet e Arsimit të Lartë i kemi publike, jopublike. Atëherë unë kam një pyetje, a ka të drejtë një universitet aktual publik që të

përcaktojë pagat e stafit vetë? E bëj këtë pyetje, sepse ne kemi një kuadër ligjor lidhur me nivelin pagave të profesoratit në universitete. Me këtë rregullim heqim dorë nga sistemi i pagave që ka përcaktuar Këshilli i Ministrave apo kjo e drejtë, autonomia organizative, i njihet vetëm universiteteve jopublike dhe atyre të ashtuquajturave universitet publike të pavarura?

Fatmir Xhafaj – Qartë, është e kuptueshme për ata.

Po, zoti Ndrecaj.

Plarent Ndrecaj – Po, këtu është vendosur një parim që i përfshin sigurisht edhe institucionet shtetërore t’i quajmë kështu, edhe pastaj janë akte të tjera rregullative që kanë të bëjnë me menaxhimin financiar dhe buxhetin e shtetit, të cilat bëjnë kufizime të caktuara.

Fatmir Xhafaj - Tani a thatë që këtu është në parim. Tani është parimi këtu, kur të vemi atje e shikojmë, mbaje rezervë, nëse nuk është, i kthehemi përsëri dhe themi: më fal, zoti Ndrecaj nuk e keni sqaruar këtu, tek ky kapitull. Pse duhet të mbajmë dy qëndrime? Njëherë thatë që ky është një nen parimor, tani nuk u dashka të themi që është nen parimor, hyr në detaj. Ku deshëm ne thamë që shiko se ky është parimor, do të vëmë parimin, tani ku duam ne, do të themi jo duam rregullin se nuk është parimi.

Duhet të mbajmë një qëndrim.

Biem dakord, pastaj e shikojmë. Kini durim, nëse kemi gabuar ndonjë gjë i kthehemi prap.

Po zonja Hafizi.

Mimoza Hafizi - Zonja Hysi ka të drejtë që shqetësohet për këtë pikë sepse mesa megjithëse nuk kemi kaluar ende të gjitha nenet por nuk ekziston një nen në këtë ligj që të thotë që universitete aktuale publike i nënshtrohen sistemit të pagave, ndërkohë që është thënë për modelin që keni përdorur për universitetet publike të pavarura që këto universitete nuk i nënshtrohen sistemit të pagave. Mbase ka nevojë jo këtu por në një vend tjetër që të sqarohet.

Fatmir Xhafaj – Ta lëmë këtu. Këta kanë dhënë principin, nëse nuk na detajohet dhe nuk na përputhet, atëherë, Alma do ta mbajë shënim. Alma, ju lutem. Zonja Hysi, a biem dakord?

Me këtë rezervë kalojmë edhe nenin 3.

Neni 4.

Vasilika Hysi – Te neni 4 është thjesht një riformulim i pikës 3, sepse si rregull, nga teknika legjislativë, formulimi që Këshilli i Ministrave nxjerr akte nënligjore për përcaktimin e kategorisë së individëve që përfitojnë nga kjo e drejtë, vihet në fund. A jeni dakord?

Plarent Ndreca - Kjo nuk e cenon përmbajtjen e pikës 3, nuk ka problem, besoj unë.

Fatmir Xhafaj - Dakord.

Vazhdojmë me nenin 5. “Roli i shtetit në arsimin e lartë”.

Vasilika Hysi – Është thjesht nga pikëpamja e teknikës legjislativë.

Në radhë të parë sugjeroj që në paragrafin e parë duhet të nxjerrim rolin e shtetit dhe në pjesë të dytë të nxjerrim përgjegjësitë dhe detyrimet sesi e realizon shteti këtë përgjegjësi të vetën. Pra, është një riformulim, “Shteti ushtron funksione rregullatore dhe themeluese të Institucioneve Publike të Arsimit të Lartë si edhe financon arsimin e lartë e kërkimin shkencor”. “Shteti nëpërmjet organeve dhe strukturave përgjegjëse të tij ka përgjegjësitë dhe detyrimet si më poshtë vijon:...” dhe fillojnë me radhë, garanton autonominë, lirinë e të tjera.

Fatmir Xhafaj – Dakord. Faleminderit!

Neni 6. “Përkufizimet”.

Vasilika Hysi – Lidhur me nenin 6 është problemi i teknikës legjislativë. E para, është që të gjitha përkufizimet duhet të renditen sipas rendit alfabetik.

Fatmir Xhafaj – Me pikën e parë jemi të gjithë dakord besoj. Po.

Vasilika Hysi - E dyta, lidhet me pikën 4 të këtij neni. Në pikën 4 jepet përkufizimi i Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe thuhet se “janë persona juridikë që ofrojnë arsim të lartë” dhe thuhet, gjithashtu, që “format e organizimit janë institucione publike, jopublike si edhe publike të pavarura në arsimin e lartë”.

Zoti kryetar, ky nen duhet parë në përputhje me nenin 24 të Kodit Civil, i cili thekson se personat juridikë i kemi publikë dhe privatë dhe përmend që në kategorinë e institucionit juridik publik janë entet publike. Në këtë përkufizim që jepet, nuk del e qartë se ky institucion i ri hibrid që krijohet, pra Institucionet e Arsimit të Lartë, janë ente publike. Nëse do të marrim përgjigjen që janë ente publike, duhet të kemi parasysh

edhe Kodin e Procedurave Administrative që kemi miratuar këtu në Kuvend, se cilat janë entet publike dhe si krijohen. Në bazë të ligjit “Për organizimin dhe funksionimin e organeve kolegjiale”, por edhe të Kodit të Procedurave Administrative, entet publike nuk mund të krijohen me vendim të Këshillit të Ministrave. Entet publike krijohen me ligj për mbrojtjen e interesit publik. Në rastin konkret kjo formë që jepet në këtë përkufizim, institucioneve publike të pavarura të arsimit të lartë u njihet e drejta të krijohen me vendim të Këshillit të Ministrave. Kjo është çështje parimore.

Plarent Ndreca – Atëherë, siç thotë me të drejtë dhe zonja Hysi, sigurisht, në nenin 24 të Kodit Civil përcaktohen llojet e personave juridik që janë publikë dhe privatë, por në këtë nen përcaktohen edhe nënkategoritë e personave publikë dhe thuhet që “janë persona juridikë publikë ndërmarrjet shtetërore, që financohen nga buxheti i shtetit dhe nga burime të tjera, si edhe entet e tjera publike të njohura nga ligji”, jo “të krijuara nga ligji”. Ky ligj këtë ka bërë, i ka njohur si institucione dhe në një moment të caktuar individualizon nëpërmjet vendimit të Këshillit të Ministrave, ia ka deleguar këtë të drejtë Këshilli i Ministrave, një institucioni x të caktuar.

Për sa i përket pjesës që përmendet në ligjin “Për organizimin e funksionimin organeve kolegjiale”, unë gjykoj se është një referencë jo e drejtë, pasi ai është një ligj procedural, i cili rregullon mënyrën se si organizohet e funksionojnë këta organe kolegjiale, por nuk përcakton parimet, apo nuk përcakton përkufizime të entiteteve. Këtë e bën Kodi Civil, i cili thotë shumë qartë: “Ente publike të njohura nga ligji”. Ne, nëpërmjet këtij projektligji, e njohim këtë ent publik si të tillë.

Vasilika Hysi – Në fakt, është ligji i parë që e jep këtë të drejtë që një fondacion, një OJF ...

Fatmir Xhafaj – Kot që e nxjerr atë.

Vasilika Hysi - Jo, jo është këtu, kryetar, pra, enti publik i pavarur krijohet nga një OJF me vendim të Këshillit të Ministrave. Nuk mundet një OJF..

Fatmir Xhafaj - Njëherë e ke këtu ndarjen në publike, jopublike dhe të pavarur, në rregull, pastaj është mënyra se si do të krijohen. Kur të vemi atje do ta shikojmë.

Vasilika Hysi – Atëherë, mund ta lëmë pikën 4 të hapur, në varësi të të gjithë diskutimit që do të kemi për kreun 12?

Fatmir Xhafaj – Ju jeni relatorët, nëse doni ta lini, e lëmë, unë nuk kam ndonjë gjë, por mua nuk më duket që ka ndonjë konflikt këtu me Kodin Civil. Mënyrën e krijimit e diskutojmë, kur të vemi atje.

Vasilika Hysi – Enti publik nuk mund të krijohet, atëherë, ta lëmë të hapur formën organizimit.

Fatmir Xhafaj - Po.

Plarent Ndreca – OJF-ja nuk krijon, OJF-ja e kërkon, është kërkuese, krijuesi është Këshilli i Ministrave.

Fatmir Xhafaj – Po dakord, kur të vemi atje, ju lutem se nuk është ky në këtë nen. Dakord

Vasilika Hysi - Në pikën 9 ka një përkufizim...

Fatmir Xhafaj -Në cilën pikën? Te përkufizimi?

Vasilika Hysi - Se po te ky nen, te përkufizimet, ka një përkufizim për vendosjen e kushteve për një institucion të arsimit të lartë. Nëse e lexojmë përkufizimin që është bërë këtu ku thuhet që “kushtet vendosen nga ministria vetëm në rast inspektimi”. Ky përkufizim bie ndesh me këtë rregullim që bëni në ligj, konkretisht në nenin 7, germa “k”, ku i jepni të drejtë ministrit përgjegjës të Arsimit të vendosë kushte, të vendosë pezullimin e veprimtarisë, jo vetëm në bazë të raportit të inspektimit, por edhe të akreditimit, të auditimit dhe të ligjshmërisë. Pyetja ime është: do t’i qëndroni të drejtës që ka ministri përgjegjës të vendosë kushte vetëm në rastet kur bën auditim apo edhe në rastet kur bën akreditim? Nëse e bëni me akreditim, duhet të shikojmë marrëdhëniet me Bordin e Akreditimit, i cili është i pavarur, thoni ju dhe vendimi është përfundimtar.

Fatmir Xhafaj- Këtu është se kur vendosen kushtet.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Mimoza Hafizi - Bordi i Akreditimit neni 14, pika 2, thuhet: “Bordi i Akreditimit merr vendimin përfundimtar mbi akreditimin e institucioneve të arsimit të lartë dhe programeve që ato ofrojnë”. Pra, është bordi që merr vendimin përfundimtar dhe jo ministria. Ka konflikte të tri neneve të ndryshme.

Fatmir Xhafaj – Po, zoti

Plarent Ndreca - Duhet ta kemi të qartë pikën 9 se është përkufizim i një termi që është vendosja e kushteve për një institucion të arsimit të lartë. Unë jam dakord me zonjën Hysi në parim, por rezervoj të drejtën ta verifikoj.

Dua të sqaroj pikën për akreditimin, flitet vetëm për programet. Pra, bordi dhe akreditimi institucional, ndërsa për mbylljen e një institucioni, kjo është histori tjetër, që i përket ministrit, ky i fundit propozon.

Fatmir Xhafaj – Dakord.

Vasilika Hysi- Zoti kryetar, përsëri te ky nen është përdorur folja “shlyen”, a jeni dakord të përdorim foljen “paguan”?

Fatmir Xhafaj – Në të gjitha flitet për vlera monetare?

Vasilika Hysi - Flitet për vlera monetare. Janë tarifa. Paguhet lekë dhe nuk shlyhen.

Fatmir Xhafaj – Dakord.

Vasilika Hysi - Po në këtë nen, pika 20, përkufizimi që i jepet sistemit të studimeve me kohë të zgjatur, këtë pyetje ia bëra edhe zotit Xhuvani, i cili më sqaroi që ky sistem nuk jepet për ciklin e parë, por lejohet për ciklet e dyta, në rast se shikojmë këtë përkufizim me rregullimin që bëni në nenin 68, pika 3, këto janë kontradiktore. Do t'i qëndroni përkufizimit që i bëni pikës 20 të nenit që po diskutojmë apo rregullimit që bëni në nenin 68, pika 2?

Në këtë përkufizim, ju caktoni kohëzgjatjen e studimeve me kohë të zgjatur, ndërkohë që në ligj nuk gjendet në asnjë nen kjo kohëzgjatje. I qëndroni kohëzgjatjes që është dyfishimi i kohës normale apo do ta rregullojmë në nenin 68?

Fatmir Xhafaj – Po, zoti

Aleksandër Xhuvani - Po e jap unë përgjigjen. Këtu është në parim dhe tregohet fakti se janë dy mënyra për mësimdhënien: mësimdhënia tradicionale që bëhet me pjesëmarrjen në auditor dhe të gjitha mënyrat e tjera në distancë e të tjera me radhë që janë quajtur dikur me fjalën e huaj, *part-time*. Ne tashmë kemi ngulur këmbë si komision që edhe nëse bëhen studime me të gjitha teknologjitë e tjera përveç asaj tradicionale, është e rëndësishme që përmbajtja e formimit të jetë e njëjtë. Pra, numri i krediteve, numri i orëve, nëse e bëni për dyfishin e kohës apo jo, do të merrni detyrimit të njëjtin formim dhe të njëjtën sasi informacioni. Ky është sensi që kemi

dashur këtu të japim si përkufizim. Pra, është përkufizimi i llojit të studimeve me kohë të zgjatur. Më pas nëse zbatohet vetëm për ciklin e dytë apo të tretë, është çështje tjetër e detajuar më vonë.

Fatmir Xhafaj – Cili është problemi?

Vasilika Hysi - Unë e kuptoj logjikën tuaj, po kur keni dhënë përkufizimin, keni thënë se përfshin organizimin e programeve të studimit me të njëjtën ngarkesë akademike të programit të studimit me kohë të plotë, por me kohëzgjatje më të madhe. Po t'i referohemi nenit 68, pika 2 thuhet: “Studimet me kohë të zgjatur mund të ofrohen në programet e studimit deri në dyvjeçare me karakter profesional për ciklin e dytë të masterit profesional dhe nuk lejohet të caktohet për programet e studimit që i japin të drejtë ushtrimit të profesionit të rregulluar, të cilat organizohen vetëm me kohën e plotë të studimit”. Pra, nuk e jepni për çdo lloj programi.

Shqetësimi i dytë është se këtu në këtë nen që rregullon formën e studimeve, ju nuk keni përcaktuar afatet e kohëzgjatjes, por i jepni te përkufizimi. A mos është më mirë ta rregullojmë në këtë nen, si edhe të rregullojmë përkufizimin?

Fatmir Xhafaj - Është parimore, shumë mirë e kanë. Dyfishi i kohëzgjatjes. Unë, që nuk jam profesor si puna juaj e kuptoj se nëse ai e ka katër vjet normalen, nuk mund të bëjë më shumë sesa tetë vjet shkollë.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Kjo është logjika, që ai të mos shkojë 16 vjet dhe të hiqet si kungulli në arrë! Ashtu si nuk kemi pranuar atë që për 6 muaj është bërë gjyqtar, nuk kemi pse të pranojmë edhe këtë që me 16 vjet të bëhet shkencëtar. Ose bëhet, ose nuk bëhet, ose e ka me pasion, ose jo. Nuk është çështje qejfi këtu.

“Titujt akademikë”.

Vasilika Hysi - Lidhur me “titujt akademikë” në kategorinë “profesor” ju përfshini titujt akademikë “profesor”, “profesor i asocuar”, “profesorët e meritës”, “akademik i asocuar” dhe “akademik”, unë jam dakord.

Pika 33 e po këtij neni. Ju e keni futur këtë lloj kategorish te përkufizimet dhe nuk e gjej në asnjë nen të ligjit ku citohet “akademik i asocuar”, “akademik”, më fal nëse nuk kam qenë e vëmendshme, por në këtë ligj nuk gjen rregullime të titujve siç i gjejmë te ligji aktual. Nuk thuhet që titulli “akademik” dhe “akademik i asocuar” jepen në bazë

të ligjit “Për Akademinë e Shkencave”. Ju e keni hequr padashur nga ligji i vitit 2007, pra nga ligji ekzistues disa rregullime që bëjnë lidhjen midis titujve akademikë në universitet me titujt që rregullohen me ligjin “Për Akademinë e Shkencave”. Nëse i kemi futur te përkufizimet, atëherë logjika e do që ato duhet të jenë përdorur diku në ligj, por ato nuk i keni përdorur gjëkundi.

Fatmir Xhafaj - E para, që ta mbyllim këtë. A ka ndonjë gjë që të jenë titujt?

Vasilika Hysi - Nuk kam asgjë dhe duhet të jenë.

Fatmir Xhafaj - Nëse nuk do të përdoren në ligj, duhet të hiqen që këtu.

Po, zoti

Aleksandër Xhuvani - Më lejoni të sqaroj historinë, pse titujt akademikë...

Fatmir Xhafaj – Jo, në parim, a bini dakord që nëse është te përkufizimi, duhet të jetë i shtjelluar në ligj?

Aleksandër Xhuvani - Jam plotësisht dakord, por problemi është këtu që meqenëse qeveria ka ngritur edhe një komision tjetër që merret me çështjet e shkencës në Republikën e Shqipërisë edhe emërimi i ligjit ka ndryshuar nga versionet e parë, ku thuhet ligji “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë”, institucionet e arsimit të lartë nuk mund të japin dot titujt “akademik”, “akademik i asociuar” dhe bëhen në një vend tjetër. Pra, ose të hiqen që këtej ose të lihen dhe t’u vihet referencë, poshtë: çështje juridike.

Fatmir Xhafaj - A mund ta bëjmë: “Përmbajtja në nenin kaq, të rregullohet me një ligj të veçantë”. Ka vlerë? Të fusim një nen më mbrapa.

Plarent Ndreca – Pika 33, ka sqaruar se çfarë përfshin titulli “profesor”, pra ka kategorizuar dhe ka përcaktuar.

Fatmir Xhafaj – Ka përcaktuar titujt e kësaj kategorie.

Plarent Ndreca – Kjo është e rregulluar në nenet përkatëse se çfarë profesori bën. Nuk ka një dispozitë përkatëse që thotë se është e rregulluar konkretisht, por në çdo dispozitë që flitet për organizimin akademik të institucioneve të arsimit të lartë, përcaktohet se ku ushtron funksionet e tij profesori dhe si është e renditur në shkallën hierarkike.

Fatmir Xhafaj – Unë që nuk jam akademik duhet ta di se cili e mban dhe si e merr këtë titull.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Plarent Ndreca - Është tek ligji.

Fatmir Xhafaj - Atëherë mos e thuaj këtu, por përcaktoje: “sipas ligjit”.

“Profesor i asociuar” është këtu.

“Profesor i meritës”, nuk është. Duhet ta sqaroni, sepse është pjesë e sistemit dhe nuk është tek ai ligji.

Plarent Ndreca - Kam përshtypjen se është e përkufizuar dhe e rregulluar. Të bëjmë një link.

Fatmir Xhafaj – E mbajmë këtë rezervë, nëse nuk është duhet të bëni ju një sqarim, të fusni një amendament, qoftë edhe me referencë tek ligji, siç thotë profesori, për ta lënë të hapur një dritare për nesër. Jam dakord. Lëreni një dritare të hapur që do të ndërtohet sipas ligjit për këtë, për atë, pa e specifikuar titullin e ligjit, ligjit kuadër që rregullon veprimtarinë shkencore dhe akademike në Shqipëri. Pak a shumë me sa kuptohet do të ketë një ligj të veçantë, apo jo?

Vasilika Hysi – Jam dakord.

Fatmir Xhafaj - Neni 7. Ministria përgjegjëse për Arsimin.

Vasilika Hysi - E falënderoj profesor Xhuvanin që më sqaroi për një sërë pyetjesh që kisha për këtë nen. Përfundimisht do të ndryshojë edhe titulli i këtij kreu, do të themi: “Organizimi i arsimit të lartë dhe i kërkimit shkencor në institucionet e arsimit të lartë”.

Nuk është kuptuar, se nëse ju thoni organizimi i arsimit të lartë dhe kërkimi shkencor, ky i fundit nuk merret vetëm me institucionet e arsimit të lartë, por me kërkimin shkencor, me shkencë merren edhe institucione të tjera jashtë institucioneve të arsimit të lartë. Profesor Xhuvani sapo tha se është ngritur një grup pune që po punon për një ligj “Për kërkimin shkencor”. Duhet të jemi korrektë, nëse do ta vëmë në titull, nuk ka nevojë ta shtojmë në çdo nen që ndodhet nën kreun II.

Plarent Ndreca - Arsyeja e të gjitha argumenteve që tha profesor Xhuvani është, sepse është bërë titulli i ligjit kështu. Për të kuptuar se çfarë shkruhet më poshtë për kërkimin shkencor flitet gjithmonë për institucionet e arsimit të lartë, pra, është thënë: “Për arsimin e lartë, kërkimin shkencor, institucionet e arsimit të lartë në Republikën e

Shqipërisë”, nëse do ta citojmë në çdo nen këtë koncept, unë nuk jam kundër, por nuk e di se si është nga ana e teknikës legislative.

Fatmir Xhafaj – Titulli i ligjit është i qartë: “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë”.

Kreu II, “Organizimi i arsimit të lartë dhe i kërkimit shkencor”. Nuk mund ta thuash, sepse e ke në ligj. Nuk mund ta zbatosh këtë gjë në institucionet akademike, shkencore që nuk janë në varësinë e ku di unë, për shembull Ministria e Drejtësisë ngre një institucion për kërkimet në fushën e së drejtës, pra nuk e përfshin. E zbaton dot këtë?

Vasilika Hysi - Jo.

Zoti kryetar, unë e bëra këtë pyetje, sepse ka disa agjenci që rregullohen në ligj. E kanë zgjeruar pak më shumë rrethin gjatë rregullimeve të tyre. Unë jam dakord që duhet të jetë vetëm për institucionet e arsimit të lartë, përderisa ka një ligj të veçantë për shkencën.

Unë e bëra këtë sqarim, sepse ky ligj miratohet, por më pas në rast se lind një problem, të gjithë njerëzit do t’u referohen procesverbaleve dhe frymës së diskutimeve që i bëjmë projektligjit, për të kuptuar se çfarë qëllimi ka pasur ligjvënësi. Këto procesverbale Gjykata Kushtetuese tashmë i ka bërë praktikë dhe i administron në proces dhe është mirë që shumë gjëra t’i sqarojmë. Ndoshta ju dhe unë i kemi të qarta, por këto bëhen edhe për të lënë rekorde për ata që vijnë pas nesh.

Lidhur me nenin 7, po e nis me titullin e nenit, ku thoni: “Ministria përgjegjëse për arsimin”, në fakt, ky nen nuk rregullon vetëm se kush është ministria përgjegjëse për arsimin, por edhe kompetencat që ka kjo ministri. Prandaj do të sugjeroja të bënit një përkufizim ose një riformulim të emërimit të nenit.

E dyta, do të kërkoja që paragrafi i parë i këtij neni të riformulohet, ku të thuhet: “Ministria përgjegjëse për arsimin është institucioni që realizon programin qeverisës në fushën e arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor në të” dhe pika 2: “Ministria ka këto kompetenca”, të cilat duhet t’i bëjmë shkurt: “harton, propozon...”; nuk mund të bëjmë fjali rrjedhëse.

Mënyra sesi është shkruar, nga pikëpamja e teknikës legislative, është e lodhshme dhe e vështirë për të kuptuar kompetencat e ministrisë. Kjo ishte në terma të përgjithshme për sa i përket teknikës legislative.

Nuk e di nëse jeni dakord, para se të kaloj te çështja e përmbajtjes.

(Kryetari i komisionit flet pa mikrofon.)

Lidhur me përmbajtjen, kam një vërejtje për formulimin e germës “gj”.

Në germën “gj” ju thoni se “ministria është përgjegjëse për mbështetjen me infrastrukturën e nevojshme për veprimtarinë kërkimore-shkencore vetëm në institucionet publike të arsimit të lartë”. Këtë e kemi thënë disa herë dhe ky është edhe shqetësimi që kanë pasur të gjithë, por, nëse i referohemi përmbajtjes së pikës 1 të nenit 109 të ligjit dhe përmbajtjes së neneve 110 dhe 111, rezulton që ministria nuk është përgjegjëse vetëm për...

Fatmir Xhafaj – Tani, ju lutem, hiqeni kur të shkojmë tek ai nen. I thuaj, më fal, ose ndrysho...

Vasilika Hysi – Nuk qëndron.

E pra, ku qëndron?

Fatmir Xhafaj – Ai atje ta ka thënë.

Ju lutem, edhe një herë, që të jemi korrektë: Projektligj “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor të arsimit të lartë”, të vjen te germa “gj” dhe të thotë: “mbështetjes me infrastrukturë për veprimtarinë kërkimore vetëm në institucionet publike të arsimit të lartë”. Nëse ato nuk janë institucione të arsimit publik, te neni të cilit i referoheni, hiqeni atje. Ky e ka pranuar këtu dhe thotë: “ose do të ndryshojë...”, do të thotë “përveç atyre, edhe këto”.

Vasilika Hysi – Atëherë...

Fatmir Xhafaj – Por ta ka pranuar. Kur të shkosh tek ai nen, duhet t’i thuash ministrisë: “këto nuk janë institucionet e tua. Përse i përfshin në këtë ligj?” dhe ai thotë: “janë institucionet e mia dhe do të japë argumentet. Jo...”, do të thotë “dakord, e pranoj, nuk janë institucionet e mia, por e kam të nevojshme”. Atëherë, ndrysho ligjin më lart. Kjo është logjika, se po të shkoni atje, nuk arrijmë dot të dalim nga kjo.

Ka vërejtje për këtë formulim?

Vasilika Hysi – Zoti kryetar, nëse do të mbajmë këtë formulim, hidhen poshtë një sërë nenes që lidhen me...

Fatmir Xhafaj – Bukuri. Kur të arrijmë tek ato nene, hidheni poshtë.

Dakord.

Ka vërejtje tjetër për këtë gjë?

Vasilika Hysi – Po, te germa “k”.

Në germën “k” të nenit 7 njihet e drejta që ka ministri përgjegjës për arsimin, që të vërë kushte për institucionin ose të pezullojë veprimtarinë e tij, bazuar në tre lloj raportesh: në raportin e kontrollit të ligjshmërisë, të akreditimit dhe të auditimit.

Mënyra sesi është formuluar germa “k”, bie ndesh me rregullat e përcaktuara në nenet 13 dhe 14 të projektligjit, por mbi të gjitha me vendimin e Gjykatës Kushtetuese, konkretisht me vendimin nr. 9 të vitit 2008 të gjykatës, i cili, më lejoni ta citoj, thotë: “Meqenëse arsimi i lartë është një shërbim publik, me ligj mund t’i jepen organeve të pushtetit ekzekutiv kompetenca kontrolluese mbi universitetet, por këto kompetenca duhet të jenë të balancuara dhe proporcionale në mënyrë që ushtrimi i tyre të mos cenojë autonominë e institucioneve të arsimit të lartë, që është thelbi i vetë qeverisjes dhe të kontribuojnë në zhvillimin pozitiv të marrëdhënieve të ndërsjella”.

Për një problem të tillë, Gjykata Kushtetuese është shprehur: “Ushtrimi i tagrit të vendimmarrjes përbën një shprehje të efektivitetit të autonomisë institucionale dhe ndërhyrja e shtetit pikërisht në këtë aspekt do të sillte vështirësi në zbatimin e ligjit dhe do të cenonte standardet kushtetuese të kësaj autonomie, si dhe lirinë akademike”.

Çështja e parë është: a ka të drejtë ministri përgjegjës që të pezullojë veprimtarinë e një institucioni mbi raportin e akreditimit? Kush ka të drejtë të vërë kushte, Bordi i Akreditimit apo ministri?

E para, e kuptoj që ministri ka të drejtë që në raport, kur kontrollon ligjshmërinë, të vërë kushte dhe ta pezullojë për ligjshmëri ose kur ka abuzime me fondet, por, në raport me Bordin e Akreditimit dhe Agjencinë e Kontrollit të Cilësisë, mendoj që kjo është një ndërhyrje flagrante e ministrit përgjegjës të arsimit te kompetencat e një institucioni të pavarur.

Çështja e dytë: kush e pezullon veprimtarinë e një institucioni, Këshilli i Ministrave apo ministri? Unë kam idenë, më falni që e them...

Fatmir Xhafaj – E keni te germa “l” këtë.

Vasilika Hysi – Jo, është po këtu te germa “k”.

Fatmir Xhafaj – “Propozimi i këshillit për mbylljen e veprimtarisë së institucionit bazohet në raportin...”.

Vasilika Hysi – Në germën “k”, zoti kryetar, thuhet që ministri...

Fatmir Xhafaj – Kush e vendos, pastaj ai propozon për ta mbyllur.

Vasilika Hysi – Jo, jo, në germën “k” thuhet që ministri vendos pezullimin e veprimtarisë.

Fatmir Xhafaj – Jo, të lutem! Thotë: “vendos kushte për institucionin për pezullimin e veprimtarisë së tij bazuar në raportet...” dhe pastaj “propozimi i këshillit për mbylljen e veprimtarisë...”.

Vasilika Hysi – Më falni! Në rast se ka një raport akreditimi, pezullimin e bën bordi; është gjë tjetër.

Fatmir Xhafaj – Mirë pra, kjo është gjë tjetër. Ta diskutojmë, ta ndajmë këtë gjë.

Vasilika Hysi – Po, t’i ndajmë këto tre raporte.

Fatmir Xhafaj – Por germa “k” ka germën “l” mbrapa. Po t’i shikosh, janë në harmoni me njëra-tjetrën.

Plarent Ndreca – Mund të bëj një sqarim?

Fatmir Xhafaj – Po, urdhëroni!

Plarent Ndreca – E para, në lidhje me vendimin e Gjykatës Kushtetuese, unë do të kërkoja që ai vendim të sqarohet dhe të bëhet i ditur në kontekstin që është marrë dhe i gjithë ai paragraf që u përmend ka të bëjë me aktin administrativ. Pra, vendimi i Gjykatës Kushtetuese ka përcaktuar qartësisht që ministria përgjegjëse për arsimin nuk ka të drejtë të shfuqizojë akte të institucioneve të arsimit të lartë.

Vasilika Hysi – Po.

Plarent Ndreca – I gjithë sqarimi që ka bërë Gjykata Kushtetuese është në këtë kontekst, por kjo nuk i heq të drejtën ministrisë, si përfaqësuese e ekzekutivit, që të pezullojë veprimtarinë e institucionit të arsimit të lartë apo t’u heqë licencën, jo ministri, Këshilli i Ministrave, institucioneve të cilat shkelin ligjin, nuk kanë raport pozitiv të auditimit apo nuk kanë akreditim institucional.

Për të kaluar te pjesa e bordit, nuk ka ndeshje të përcaktimeve dhe të dispozitave, sepse ministri bën pezullimin bazuar në raportin e Bordit të Akreditimit dhe Bordi i Akreditimit merr vendim për...

Vasilika Hysi – Përfundimtar.

Plarent Ndreca – Jo, merr vendim përfundimtar për akreditim institucional. Thotë: “Institucioni iks nuk akreditohet institucionalisht” dhe, mbi bazën e këtij vendimi, pezullimi pastaj bëhet nga ministri, sepse “Bordi i Akreditimit nuk pezullon institucionin në ushtrimin e...” Duhet të ndajmë ushtrimin e funksionit, po themi, si shoqëri tregtare për privatët, nga ushtrimi akademik i veprimtarisë.

Bordi i Akreditimit ndalon ushtrimin e veprimtarisë nga ana akademike, kurse ndalimin si institucion e bën përkohësisht ministri, pra me pezullim, pastaj Këshilli i Ministrave i heq licencën përfundimisht.

Jam i qartë, apo duhet ta sqaroj më tej?

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Atëherë, po marr një shembull sikur shoqëria “iks” ka bërë kërkesë për licencim.

(Deputetja Hysi ndërhyrje pa mikrofon.)

Jo, është më e thjeshtë, sepse për publikun...

(Deputetja Hysi ndërhyrje pa mikrofon.)

Jo, jemi edhe privat, se i kemi këtu.

(Deputetja Hysi ndërhyrje pa mikrofon.)

Jo, jo, ju lutem tani. Unë po marr shembull privatin, sepse është më i thjeshtë për t’u kuptuar, sepse licencimin e kërkon privati te Këshilli i Ministrave.

Atëherë, shoqëria iks kërkon licencim për të ushtruar veprimtarinë në fushën e arsimit të lartë. Pas marrjes së licencimit nga Këshilli i Ministrave, akreditohet institucionalisht. Në rast se Bordi i Akreditimit nuk ia jep këtë akreditim, janë kushtet që ministri ta pezullojë dhe të kërkojë në Këshillin e Ministrave heqjen fare të licencës kësaj shoqërie tregtare që e ka marrë dhe nuk e lejon që të ushtrojë veprimtarinë në fushën e arsimit të lartë. Kjo është ideja.

Fatmir Xhafaj – Ka një institucion akreditimi?

Vasilika Hysi – Po, prandaj...

Fatmir Xhafaj – Dakord.

Ky nxjerr një raport dhe thotë: “Vendosi”.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Në rregull.

Automatikisht zbatohet. Kush do ta zbatojë këtë? Është ministri, se është organ ekzekutiv. Ministri do të shkojë t'i thotë: "kam një vendim të bordit dhe mbi këtë bazë unë vendos këtë dhe shkoj në Këshillin e Ministrave të heq licencën".

Ministri, se ai është ekzekutivi. Ai në vetvete po të jetë për këtë komision akreditimi, vendimin kush do ta zbatojë? Do ta marrë ministri, se ka fuqi ekzekutive, sepse Komisioni i Akreditimit, siç e quani ju, kërkoj ndjesë edhe një herë për terminologjinë, se unë nuk jam ekspert i fushës...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Bordi, në rregull.

Në rastin konkret, me vendimin e Bordit ata jetojnë edhe njëqind vjet. Do të vazhdonin ende kështu, siç ishin ato universitetet fantazmë, por ai merr vendimin dhe e ekzekuton ministri. Për aq pjesë të kompetencave që ka ministri, pjesën tjetër kur ai duhet t'i heqë licencën, shkon te Këshilli i Ministrave. Kjo është logjika.

Vasilika Hysi – Ta sqaroj pak?

Fatmir Xhafaj – Po.

Vasilika Hysi – Germa "k" është pjesërisht e drejtë kur bëhet fjalë për kontroll ligjshmërie dhe auditimi, por të vendosësh kushte mbi raportin e akreditimit, mua nuk më duket e drejtë, sepse në vendimin e Bordit të Akreditimit vendosen kushtet.

Zoti Xhuvani e di shumë mirë, pasi është specialisti më i mirë. Unë kam qenë vetë bashkë me zotin Xhuvani kur kemi bërë vendime dhe...

Fatmir Xhafaj – Dakord. Mund ta ndani akreditimin dhe zbatimin e vendimeve të akreditimit?

Plarent Ndreca – T'jua shpjegoj edhe një herë. Bordi i Akreditimit merr një vendim edhe me kusht. Pra, ndodh që Bordi i Akreditimit thotë...

(Deputetja Hysi ndërhyrje pa mikrofon.)

Po pra, kjo germë nuk ka fare lidhje me vendimin e bordit. Thjesht vendimi i bordit i jep mundësinë ministrit për të marrë një vendim administrativ për licencën e institucionit.

Do ta ndajmë edhe një herë tjetër: licencën e institucionit...

Fatmir Xhafaj – A mund ta ndajmë në dy pjesë, ku për këtë pjesën ku lidhet me akreditimin të kemi një formulim më vete dhe pjesën që kemi për ligjshmërinë dhe auditimin, meqenëse është kompetencë e...?

Plarent Ndreca – Në rregull.

Fatmir Xhafaj – Dakord.

Mimoza Hafizi – Nëse mund të shtoj diçka, te pjesa e akreditimit...

Fatmir Xhafaj – Po pra, e kaluam.

Mimoza Hafizi – Jo te pjesa e akreditimit.. Po, do ta ndajmë.

Fatmir Xhafaj – Ndani një përgjegjësi më vete, bazuar te vendimi i kësaj.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Mimoza Hafizi – Bazuar në vendimin e Bordit të Akreditimit, jo në raport.

Fatmir Xhafaj – Po, e mbyllëm këtë pjesë.

Vasilika Hysi – Po në këtë nen, zoti kryetar, në ligj i kemi dhënë ministrit të drejtën të pezullojë rektorin.

Fatmir Xhafaj – Ku e ke këtë?

Vasilika Hysi – Është në nenin 38, por nuk e gjejmë të rregulluar te kompetencat këtu. Pra, në ligj ka shumë kompetenca të cilat nuk janë të përcaktuara edhe në nenin që po diskutojmë. Konkretisht, ministrit i janë dhënë dy kompetenca.

E para, e drejta e pezullimit të rektorit dhe propozimit për shkarkim të tij.

E dyta, i është dhënë e drejta e shkarkimit të autoritetit drejtues të institucionit të arsimit publik.

Në fakt, ju këtu nuk ia njihni ministrit këtë kompetencë, ndërkohë që te neni 38, pikat 10 dhe 11, ia njihni. Do ia lini, apo do t'ia hiqni?

Plarent Ndreca – Në fakt, kjo është arsyeja pse nenin 7 nuk e kemi ndarë në dy momente, siç e ndatë ju, dhe themi: “Ministria përgjegjëse për arsimin është institucioni që realizon programin qeverisës në fushën e arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor përmes këtyre instrumenteve” dhe nuk i kemi quajtur kompetenca, sepse ka edhe kompetenca, siç e thatë ju, në vijim, por nuk janë instrumente për realizimin e qëllimeve që parashikon neni 7.

Ne këtu kemi pasur qëllim për të përcaktuar instrumentet se si ministria përgjegjëse realizon programin qeverisës në fushën e arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor. Prandaj është ndërtuar në këtë strukturë.

Fatmir Xhafaj – Pra, në qoftë se ai e ka këtë instrument, që e quani ju, që nuk është veçse një kompetencë, se instrumenti është për të realizuar kompetencën. Ka një diferencë ndërmjet kompetencës, të drejtës që ke për të ushtruar autoritetin tënd, dhe instrumentit me të cilin e ushtron këtë të drejtë.

Përveç kësaj, në qoftë se kjo është në ligj, duhet pasqyruar edhe këtu.

Plarent Ndreca – Më lejoni edhe një moment!

Fatmir Xhafaj – Pse druheni ta vendosni?

Plarent Ndreca – Nuk ka asnjë problem, e shtojmë, por do ta bëjmë këtë nen shumë të gjatë.

(Deputetja Hysi ndërhyr pa mikrofon.)

Më lejoni ta them edhe një herë tjetër: instrumentet për realizimin e politikave është një gjë dhe kompetencat individuale të ministrit për një moment të caktuar janë një gjë tjetër. Pra, e drejta e ministrit, siç e përmendët, për pezullimin e rektorit është një kompetencë individuale që nuk është domosdoshmërisht instrument për realizimin e politikave.

(Deputetja Hysi ndërhyr pa mikrofon.)

Plarent Ndreca – Pra, është...

Fatmir Xhafaj – Një sekondë!

Plarent Ndreca – Jo, nuk pezullon institucion, pezullon një titullar.

Fatmir Xhafaj – Fushë e kompetencave të tij është. Pastaj, të gjitha janë në funksion të përgjegjësisë së tij kushtetuese.

Plarent Ndreca – Po, por nuk është domosdoshmërisht...

Fatmir Xhafaj – Dhe ministri është autoritet kushtetues për fushën përgjegjëse...

Plarent Ndreca – Po, po, patjetër.

Fatmir Xhafaj – Dhe ai ka këto kompetenca: një, dy, tre, katër, tridhjetë, pesëdhjetë... Shënojani.

Plarent Ndreca – Por ka disa kompetenca që janë instrumente të politikëbërjes dhe disa kompetenca që janë thjesht akte administrative individuale...

(Deputetja Hysi ndërhyrje pa mikrofon.)

Fatmir Xhafaj – Patjetër.

Vasilika Hysi – Zoti Ndreca, do të isha dakord me ju në qoftë se ju do të hiqnit edhe pikën 1, ku thuhet: “verifikon ligjshmërinë e zhvillimit të zgjedhjeve në institucionet publike të arsimit të lartë dhe ia përcjell për emërim këtë kandidat fitues të zgjedhjeve për rektor në universitete publike Presidentit të Republikës”. Pra, ia jep kompetencë, i çon Presidentit propozimin e rektorit dhe nuk i jep po në ligj kompetenca që i propozon rektorit shkarkimin.

Fatmir Xhafaj – Në rregull, vendoseni edhe këtë aty.

Vazhdojmë me nenin 8 “Këshilli i arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor”.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Po. Po.

Bashkim Fino – A do të ishte më mirë që relatorja të bënte një diskutim me përfaqësuesit e qeverisë? Për ato që do të binte dakord, të bjerë dakord; për ato që nuk do të binte dakord, për ndonjë nen të caktuar, të vinim në një seancë dhe të diskutojmë ato nene me të cilat s’biem dakord midis nesh dhe qeverisë. Sepse, kështu i bie të diskutohet për çdo fjalë, për çdo gjë, është më racionale. Po harxhojmë kohën në të tjerët që po i dëgjojmë.

Fatmir Xhafaj – Do të ecim edhe pak kështu.

Bashkim Fino – Nuk shkon, kemi kaluar dy orë e gjysmë.

(Diskutim pa mikrofon)

Unë të vlerësoj ty për punën që ke bërë, por unë desha të thosha tjetër gjë: që në pikat ku ju bini dakord, bini dakord dhe bëjmë një material që të na vijë edhe ne në tavolinë. Në pesë nene apo shtatë nene, ku relatorja jonë s’bie dakord me qeverinë, i diskutojmë në një seancë tjetër se si do të vendosim ne si komision. Kaq. Këtë kisha për procedurë të përshpejtuar, se po rrimë kot tani, duke dëgjuar vetëm diskutime, që disa i kuptojmë disa s’i kuptojmë. Bëra një propozim. Ose merre në konsideratë. Në qoftë se ju vazhdoni, do të thotë që...

Fatmir Xhafaj – Do ta marr në konsideratë, sa ta mbyll këtë që fillova. Këshilli i arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor.

Vasilika Hysi – Në fakt, ky është një institucion i rëndësishëm për hartimin e politikave të arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor në institucionet e arsimit të lartë. Është dispozitë shumë e bardhë, blankete, nuk thotë asnjë gjë lidhur me drejtimin e punës: kush e drejton, kush janë ekspertët, si zgjidhen ekspertët, çfarë përvoje duhet të kenë? Është këshilli ai që bën strategjinë, dhe në bazë të strategjisë e politikave të arsimit do të vijë edhe financimi që do të bëjë agjencia, do të vijë edhe ndarja e fondeve midis universiteteve publike e jo publike e institucioneve të pavarura. Prandaj sugjeroj që ligji...

Fatmir Xhafaj – Më fal, po për këtë këshillin e arsimit të lartë dhe kërkimin shkencor, e keni?

Vasilika Hysi – Po, po.

Fatmir Xhafaj – Ky është organ këshillimor.

Vasilika Hysi – Zoti kryetar, ky është një institucion kaq i rëndësishëm...

Fatmir Xhafaj – Po ky i jep këshilla ministrit.

Vasilika Hysi – Po, më fal tani, të të them çfarë ka. Në bazë të këshillave dhe orientimit...

Fatmir Xhafaj – A ka vendimmarrje ky?

Vasilika Hysi – Jo, orienton ministrin, dhe ministri bën formulën e shpërndarjes së fondeve publike, pastaj edhe të kriterëve të fondeve publike. E para, ja, të them disa gjëra.

Ky këshill është i rregulluar në ligjin...

Fatmir Xhafaj – Unë kam shumë respekt për Almën; ngrihem në këmbë, po deshi Alma, por në fund të fundit këshilltare është. Thua është mendimi im kështu, e unë të them: jo s'është fare kështu.

Vasilika Hysi – Nuk është këshill personal i ministrit.

Fatmir Xhafaj – Por është organ këshillimor pranë ministrit.

Vasilika Hysi – Jo, jo, zoti kryetar!

Fatmir Xhafaj – Po kë këshillon? Drejtorët?

Vasilika Hysi – Po, por nuk e këshillon si duhet të flasë në parlament e të tjera, por e këshillon për të gjitha politikat e arsimit të lartë e të kërkimit shkencor.

Fatmir Xhafaj – Po në fund fare, kush vendos? Ai apo këshilli? Ministri apo këshilli?

Vasilika Hysi – Ja, ta mbaroj një çikë.

Fatmir Xhafaj – Ndjesë. Në rregull.

Vasilika Hysi – Këshilli i arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor është thelbi, zemra, që në bazë të orientimit që do t'i bëjë ministrit përgjegjës për arsimin, do të përcaktojë – ose nga kjo do të variojë – gjithçka tjetër që lidhet me fondet, me shpërndarjen e fondeve, me kreditë, me kërkimin shkencor e të tjera. Në ligjin aktual ai rregullohet në mënyrë të detajuar, më mirë se në çdo ligj tjetër në nenet 65 dhe 66, ku thuhet kush zgjidhet. Mund të zgjedhë ministri këshilltarë që nuk kanë background ose përvojë, e të jenë ekspertë të shquar të fushës? Nga kush do të zgjidhet? Kush do t'i propozojë? Si do të përzgjidhet?

E them këtë, sepse me këtë rregullim që bëhet në nenin 8, bëhet një hap mbrapa në raport me rregullimin që ka këshilli i arsimit të lartë dhe i kërkimit shkencor në ligjin ekzistues. Në qoftë se ligji ekzistues është më transparent, më i detajuar dhe ka kritere të forta, pra nuk ia lë ministrit apo Këshillit të Ministrave, por i lë në ligj shtyllat kryesore, ne këtu i kemi hequr dhe ia lëmë çdo Këshilli Ministrash që shkon e vjen, që të përcaktojë si të dojë, ndërkohë që ky do të përcaktojë edhe fondet, formulat, gjithçka tjetër. Më falni që e them këtë.

Fatmir Xhafaj – Dakord! Logjika juaj ka një gjë. Këta mund të bënin edhe këtë: ministri këshillohet nga një, dhe kaq.

(Diskutime pa mikrofon)

Jo, jo.

(Diskutime pa mikrofon)

Një minutë, ju lutem!

Bashkim Fino – Është funksionar politik, nuk është nëpunës civil. Nesër, kur të ndërrohet ministri, do të vihet një tjetër.

(Diskutime pa mikrofon)

Të lutem, më fal! Unë kam të drejtë të lëviz drejtorët e drejtorive, të cilët janë nëpunës civilë, por ama për të gjithë pjesën politike, shef kabineti, këshilltar e të gjitha, do të marr ata me të cilët dëshiroj unë të punoj, që janë në funksion të punës së ministrit.

Edhe këtu: emërohen ca anëtarë nga ministri. Çfarë problemi ka? Por ministri nuk është i marrë të emërojë një që s’është shkencëtar, apo një që s’di ta këshillojë për arsimin. Nuk mund të marrë një njeri tjetër, do të marrë një që di ta këshillojë për këtë punë. Ndaj ti thua jo. Po sikur të mos e emërojë në këshill, thua? Nënteksti yt, në diskutimin që bëtë.

Fatmir Xhafaj – Dakord, dakord! Ka një gjë.

Bashkim Fino – Ajo është çështje e ministrit.

Fatmir Xhafaj – Në qoftë se ajo është çështje ministri, ministri le ta fusë të struktura e tij, të mos e fusë në ligj. Po i dha fuqi ligjore... Duhet të sqarojmë dy-tri gjëra. Sepse, çfarë thuhet në pikën 3: “Organizimi, funksionimi dhe kohëzgjatja e qëndrimit në detyrë, përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave”

Pra, i ka dhënë një funksion këtij.

(Diskutime pa mikrofon)

Domethënë, t’i japë edhe ca kritere, sepse ia kam dhënë unë, ligji, ligjvënësi. I kam thënë: bëje këtë këshill, sepse këtë këshill unë do të ta njoh ty, do të ta reflektoj si institucion ligjor.

(Diskutime pa mikrofon)

Në rregull? Por, duhet të kem ca kritere.

(Diskutime pa mikrofon)

Po, po, patjetër.

Njerëzit që do të zgjedhë ai, patjetër, sepse njerëzit ai i zgjedh.

(Diskutime pa mikrofon)

Bashkim Fino – I thotë: dua këshilltar dhe bëni një komision që të më këshillojë për këtë gjë. E pse do ta shpjerë te Këshilli i Ministrave? Kohëzgjatja e këtij komisioni është me kohëzgjatjen e ministrit në fuqi. Për sa kohë është ministri në fuqi, do të jetë. Kur të vijë ministri tjetër, absolutisht që do të zgjedhë të tjerë. E kjo dihet. Sepse janë njerëz politikë. S’ka lidhje fare kjo. Kot e vini në pikën 3 “Me vendim të Këshillit të Ministrave”. Për mendimin tim. Këtë e njoh nga pikëpamja e organizimit.

Plarent Ndreca – Nëpërmjet këtij ligji, e pikërisht këtij neni, është tentuar të përcaktohet një organ këshillimor, në mënyrë që çdo vendimmarrje që bën ministri në lidhje me politikat e arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor, të jetë e ekspozuar dhe e argumentuar, që do të thotë se ministri do të kërkojë institucionalisht një mendim nga ky

këshill, dhe çdo gjë që nuk merr në konsideratë nga këshillat që këshilli do t'i ketë dhënë në një mënyrë institucionale, do të jetë e argumentuar. Por, është ajo që thanë zoti Xhafaj dhe zoti Fino, që në fund ngelet një organ këshillimor.

Për shkak të këtij roli që i është dhënë, kemi përcaktuar në nenin 3, që rregullat të mos i bëjë vetëm ministri. Rregullat e organizimit, funksionimit, kriteret, nuk mund t'i bëjë i njëjti organ që emëron edhe këshilltarët, le ta quajmë kështu, këta anëtarët e këshillit. Këto i bën një organ më i lartë. Pra, rregullat e lojës i përcakton një organ më i lartë se sa organi që zgjedh anëtarët. Ky është i gjithë roli i këtij organi, dhe besoj se është një e mesme midis faktit se s' duhet fare dhe faktit se duhet lënë të gjitha ministrin.

Pra, është bërë një organ i cili i bën më të përgjegjshme vendimmarrjet e ministrin. Pra, ministri është i detyruar të marrë këshilla nga ky organ, por nuk është i detyruar të marrë vendime që organi këshillon.

Fatmir Xhafaj – Në rregull.

Vasilika Hysi – Ndoshta nuk u shpreha qartë, por unë jam dakord me atë që tha zoti Fino. Ky organ është organ këshillimor. Në qoftë s'edo të jetë për aq kohë sa qëndron ministri, atëherë hajde ta përcaktojmë me kohëzgjatjen, siç e ka pasur ligji më parë, katër vjet. E para kjo.

E dyta, ky është organ i cili orienton politikat e arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor. Në nenet në vijim ne thepise, në varësi të politikave të arsimit të lartë, që është edhe letra e prioriteteve, e të tjera e të tjera, përcaktohen edhe fondet.

(Diskutime pa mikrofon)

Të mbaroj, të lutem.

Atëherë, në qoftë se ministri përgjegjës për arsimin, i emëron anëtarët, kush ia propozon atij? Ai vetë do t'i gjejë? Dikush duhet t'ia propozojë. A do të kemi ca kriteret për përzgjedhjen që do të bëjë ministri? Cila është arsyeja që ju hiqni dorë nga ato kriteret që ishin në ligjin aktual?

Fatmir Xhafaj – Diçka thelbësore: këtë nenin 3 ndajeni. Bëjeni: Organizimi, kriteret, funksionimi, dhe kohëzgjatja, qëndrimi në detyrë e shpërblimi i anëtarëve, që janë dy gjëra të ndryshme, të përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Po.

Bashkim Fino – E thashë që pari që nuk shkon pika 2 me pikën 3. Duhet të më kuptoni pse nuk shkon. Çfarë thoni ju në pikën 3? Ju thoni: Këshilli i Ministrave ka për detyrë të japë shpërblimin, të bëjë organizimin, të bëjë funksionimin dhe kohëzgjatjen e këtij këshilli.

Ndërkohë, pika 2 thotë: emërimin e anëtarëve e bën vetë ministri përgjegjës, ndërkohë që pika 1 – se e mora nga fundi e lart – është: Këshilli i arsimit të lartë dhe i kërkimit shkencor është një organ këshillimor, për politikën e arsimit të lartë, për ministrin. Prandaj thashë se nuk shkon pika 2 me pikën 3. Në qoftë se do ta lëmë me tre pika, atëherë Këshilli i Ministrave ka të drejtë të miratojë edhe anëtarët e këtij këshilli, me propozim të ministrit. Sepse, nuk mundet që Këshilli i Ministrave, organ më i lartë se një ministër, miraton shpërblimin, organizimin, funksionimin e kohëzgjatjen, vë emrat, i vë një ministër, kushdo qoftë, Bashkimi, ti, apo një tjetër. më kupton? S’ka logjikë. Do të thotë s’epo u bë me tre pika, do të thotë se Këshilli i Ministrave duhet të miratojë, me propozim të ministrit të linjës, edhe numrin e anëtarëve të këtij këshilli. Por unë e quaj më të thjeshtë, nuk e quaj kaq domethënëse. Për mua zgjidhet kjo, zoti kryetar. Si zgjidhet? Ka një këshill konsultativ, këshillimor. Është vetëm këshillimor. Dhe, duke qenë këshillimor, nuk ka nevojë as të paguhet, se e ka brenda për brenda. E miraton dhe e vendos ministri. Kaq. Mbaron. Dhe jep këshilla për të.

Fatmir Xhafaj – Më mirë bëjmë atë të parën, dhe dyshin e treshin...

Bashkim Fino – Ndërsa, në qoftë se bën pikën e tretë dhe fut Këshillin e Ministrave, automatikisht ministri propozon emrat.

Fatmir Xhafaj – E mbyllëm këtë diskutim. E mbyllën nenin 8 me këtë version.

Bashkim Fino – Dakord?

Fatmir Xhafaj – Dakord.

Atëherë, për nenet e tjera, edhe unë bie dakord me propozimin që u bë këtu, që të vazhdoni me...

(Diskutime pa mikrofon)

Ju lutem! E mbyllëm këtë diskutim. Biem dakord që 2-shin dhe 3-shin t’i bëjmë bashkë. Ju lute, biem dakord. ramë dakord të gjithë. Mund të ketë ndonjë rezervë ministria, por ramë dakord.

Kurse nenet e tjera, Alma, duhet t'i mbyllni deri në fund, dhe t'i njoftoni një orë ministrisë, që të vijë që t'i diskutoni, para se t'i kalojmë ditën e premte paradite.

Vasilika Hysi – Zoti kryetar, për ditën e premte sugjerojmë të vazhdojmë me një pjesë tjetër të ligjit, se përndryshe nuk e kapim dot...

Fatmir Xhafaj – Unë them ta mbyllim.

Vasilika Hysi – Atëherë duhet të punojmë

Fatmir Xhafaj – Po pra. Pse, e vë njeri në diskutim? Çfarë problemi ka?

Njoftojeni ministrinë. Në qoftë se nuk është dakord, do t'i kalojmë ne. Pastaj le ta zgjidhin ata.

As që e vë në diskutim fare që ata do të jenë të gatshëm në çdo moment që të përgjigjen.

Vetëm, ju lutem, juve si relatore dhe këshilltarët, duhet të ecni një çikë më shpejt.

Po.

(Diskutime pa mikrofon)

Nuk besoj se doni që ky ligj të shtyhet për në shtator.

Në rregull! E mbyllim këtu, për të vazhduar ditën e premte në ora 10. 00.

Po, profesor!

Ju lutem, një minutë.

Alekasander Xhuvani – Nuk mund të na përcaktoni një ditë kur do të ulemi me pjesëtarët që kanë bërë raportin?

(Diskutime pa mikrofon)

Në rregull. dakord.

MBLEDHJA MBYLLET

